

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 213, Korrik 2021
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Martin Camaj përherë me ne

- Redaksia e boton këtë bashkëbisedim të kuadrin e 96 vjetorit të lindjes -

7

Nga Ardian Klosi

Sot, shkrimtari dhe linguisti Martin Camaj do të kishte mbushur 85 vjeç. Në dy vjetët që do të kalonin deri sa vdiq, Camaj luajti një rol të jashtëzakonshëm në jetën tonë. Ai ishte shembulli i gjallë i qëndresës në fushën e kulturës.

Botojmë sot për herë të parë bisedën në një talk-show të Televizionit Austriak, në Mars 1991 ku Camaj ndodhej përballë një ambasadori që mbronte vijën e PPSH-së

Sot, shkrimtari dhe linguisti Martin Camaj do të kishte mbushur 85 vjeç.

Një moshë e zakonshme mund të thuhet për malësorët e tij të Dukagjinit, sidomos për një njeri aq të përkorë si profesori i Munihut. Por sëmundja e rëndë që i qe shfaqur që para se të mbushte të 65-at i rrëmbeu jetën më 12 mars 1992.

Ai e dinte shumë mirë që do të vdiste, edhe kur jemi takuar për herë të parë në Innsbruck në shkurt të vitit 1990, mandej shumë herë e ka tematizuar vdekjen në poezinë e tij (Kur të vdes më mbështillni me tesha të lesh-ta/sikurse ishte dokja...



2 KOSOVA FATOSE, SISTEMI NERVORË QENDRORE I SHQIPTARISË

Reportazh nga Sesioni XVI shkencorë me temë "Masakrat dhe krimet Serbo-malazeze në trojet shqiptare në vitet 1912-1999"

Bibliofili shkopsitës i drynave të arkave të moçme, Dr. Mark Palnikajn, me datë 18. 07. 2021, më priu për gjatë rrafshinës rrushatake dardhane. Natyra buzagaze na dhuroi një pui poetike joshëse. Meditimin panoramik ma ndërpreu kolegu im i pasionuar pas amforave të vjetra të përmbytura nga tërbimi i harbuar i moteve. Kaq u desh, që të zhyteshim vesh e ngjesh në "detin Kuq!" Vozitëm mendueshëm dhe trishtueshëm përgjatë një masivin gjigand "koralesh" të përskuqura nga gjaku martir i baticave romane, gotë, bizantine, turke e sllave.

Territori më i butë i Kosovës në raport me Shqipërinë e poshtme ka ndikuar në numrin më paktë të kështjellave të kë-tushme, por, Dardania-(Kosovare) është e gjitha krye fortësë e shqiptarizmit. Po, Po, Po ajo dhe vetëm ajo! Ashtu siç është e ditur historikisht se, ...

3 TONIN PRELA KAMPION KOMBËTAR, NË BOKS

Me datë 11 korrik 2021, në Vlorë u zhvillua kampionati Kombëtarë i Boksit për moshën U-16. Në peshën 60 kg, kampion Kombëtar u shpall Tonin Prela, nga fshati Lotaj i Shalës. Gjithashtu, boksieri Prela, u shpall edhe boksieri më i mirë i Kampionatit.



8 VEPRIMTARIA E VIII E DITËS SË PLISIT TË BARDHË

Në Kosovë për 8 vite me radhë mbahet një manifestim tradicional kulturor, i cili është pagëzuar "DITA E PLISIT".

Këtë vit, veprimtaria e VIII e tij, u mbajt në Stankaj të Rugovës, në kullën e Hysen Kurtajt (lahutar i njohur). Manifestimin e drejtoi, ideatori Ismet Krasniqi, me bashkëpunëtorët e tij, Shkrimtarin Prend Buzhala, Pikturin e poetin Idriz Bersha e Poetin e skulptorin Gjon Gjergjan.

QENDRESA E DUKAGJINIT NË PLAN

Me 15 Korrik 2021 në Njësinë Administrative Pult, është organizuar "Përkujtimorja e Qereshit". Përkujtimi i luftës së popullit në Planit, 106 vjet më parë kundër pushtesit serbo-malazez, program artistik, promovimi i resurseve të krahinës dhe eksplorimi i bukurive natyrore, panairi i produkteve ushqimore të traditës, ishin veprimtaritë që pasuruan këtë moment.

Deputetja Greta Bardeli në fjalën e saj veçoi rëndësinë e kësaj date dhe përsosi krahinën, e cila dallohet ...

RIKTHEHET PAS KATËR VITESH, MALËSORI SHQIPTARO - AMERIKAN GJON FRANI IVEZAJ TË DËSHMOJË PËR RRËNJËT DHE MALET E MALËSISË SË MADHE

Ditën e premtë, me datën 23 korrik 2021 në ambientet e Bibliotekës "Marin Barleti" të qytetit të Shkodrës u organizua një veprimtari kulturor me tematikë "takim me lexuesin", ku miku i kahershëm i kësaj biblioteke, Profesor Gjon Frani Ivezaj promovoi njëherazi dy librat e tij të fundit "Iliro Paganët dhe Sfidat e Krishterimit në Shqipëri" si dhe "Rrënjët dhe Malet e Malësisë së Madhe".

Realizimi i kësaj veprimtarie u bë nën kujdesin e veçantë të drejtorit të bibliotekës z. Maxhit Cungu dhe monitorimin profesional të znj. Linda Kavaja.

KOSOVA FATOSE, SISTEMI NERVORË QENDRORË I SHQIPTARISË

Reportazh nga Sesioni XVI shkencorë me temë "Masakrat dhe krimet Serbo-malazeze në trojet shqiptare në vitet 1912-1999"

Bibliofili shkopsitës i drynave të arkave të moçme, Dr. Mark Palnikaj, me datë 18. 07. 2021, më priu për gjatë rrafshinës rrushatake dardhare. Natyra buza-gaze na dhuroi një puhi poetike joshëse. Meditimin panoramik ma ndërpreu kolegu im i pasionuar pas amforave të vjetra të përmbytura nga tërbimi i harbuar i moteve. Kaq u desh, që të zhyteshim vesh e ngjesh në "detin Kuq!" Vozitëm mendueshëm dhe trishtueshëm përgjatë një masivin gjigand "koralesh" të përskuqura nga gjaku martir i baticave romane, gote, bizantine, turke e sllave.

Territori më i butë i Kosovës në raport me Shqipërinë e poshtme ka ndikuar në numrin më paktë të kështjellave të kë-tushme, por, Dardania-(Kosovare) është e gjitha krye fortesa e shqiptarizmit. Po, Po, Po ajo dhe vetëm ajo! Ashtu siç është e ditur historikisht se, dardanet janë iliret e verilindjes, po ashtu rezultoi se, nuk pati një unitet politik mes Dardanisë dhe Ilirisë mbase terreni i thyer gjeografik i ndau si gropëza e gjakësit dy gjiret e një ame.

Mbretëria Dardane u rrit dhe lulëzoi në luftëra me Maqedoninë. Aleksandri i madh pushtoi aq territore sa në shtetin e tij s' praronte kurrë dielli, por Dardanët nuk i nënshtroi dot. Kur keltët vërshuan vrullshëm si orkek, duke zaptuar Evropën Qendrore, dardanet e zbythën te shtegu barbarinë e tyre triumfuese. Dardania, është treguar gjithmonë e zonja për tu bërë ballë fushatave luftarake të kundërshtarëve të saj. Ajo vazhdoi të ekzistojë edhe pas zhdukjes së mbretërive të Ilirisë dhe Maqedonisë nga Roma. Vetëm në vitet 76-72 P.K legjionet Skribon Kurit i dhanë fund mbretërisë Dardane...

Debatuam për kafshimet e tërbuara turko-sllave, qëndresën e pa përkulshme dhe etimologjinë e emrave Dardani e Kosove. Debatimi na mori në rrjedhën e tij dhe na ndali në Drenicë, kraterin bazik të qëndresës çlirimtare. Nga Broja, Llaushe, Skenderaj, Qirez, Tushila, Gradica, Likoshan, Klladernice na kumboi jehona osh-timave çlirimtare të 1999-ës.

Mes reve të mungta si vegim meteori na u përshfaqen liridonët kombëtar Hasan Prishtina dhe Adem Jashari sublim e jashtëzakonisht gjallë edhe pas vdekjes. Prej ashtës së pa fund medituese na shkëputi urimi i Ndue Oroshit: "Mirë se erdhët vëllezër!" Shqiptarisht u ulëm në tervesat e Sesionit Shkencorë të XVI me temë "Masakrat dhe krimet Serbo-malazeze në trojet shqiptare në vitet 1912-1999".

Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Shoqatës së intelektualëve "Trojet e Arbrit", Ndue Oroshi.

Kryetari i Komunës Skenderaj, Bekim Jashari uroj mirë se ardhjen e kumtueseve nga Shqipëria, Maqedonia, Plava e Gucia, Tivari e Çamëria, Presheva, Metvegja e Bujanoci dhe të zotëve të shtëpisë nga

Kosova.

"Rrëfimi i Dashamirës", titullohej poema për qëndresën e familjes Jashari, që u recitua me shumë ndjenjë dhe elokuencë nga aktorja, Arbëreshe Berisha.

Poemën "Kanga e Kapedanit", të Ernest Koliqit e interpretoi plot zjarr dhe patos artistik publicisti dhe argati i artit, Martin Dedaj.



Ndue Oroshi,
Kryetari i Shoqatës së intelektualëve
"Trojet e Arbrit"

Himni i flamurit dhe caktimi i një delegacioni për të bërë homazhe në varrezat e familjes Jashari i parapriu **Seancës së parë**: "Masakrat gjatë viteve 1912-1945" që përmbante plot 25 të tema nga personalitete të afirmuar shkencore në fushën e studimeve historike dhe albanologjike, Prof. Dr. Jahja Dranaçoli, Prof. Dr. Muhamet Shtari. Dr. Qazim Nemani, Prof. Dr. Nexhmedin Bardhi, Dr. Mark Palni-



Dr. Mark Palnikaj

kaj, Dr. Rovena Meleki Vata, Dr. Fehmi Rifati, Prof. Rexhep Dedushaj, Dr. Nikollë Luka.

Seanca e dytë, i kushtojë "Masakrave gjatë viteve 1989-1989", me 21 punime ku vlen të veçohen emra të tillë, Dr. Be-

sim Morina, Dr. Lulëzim Nika, Dr. Bedri Muhaderi, Prof. Teuta Shala, Dr. Zog Çoçaj, Mr se Engjëll Berisha, Mr se Ramadan Mehmetaj, Mr se Agim Hyseni, Mr se Rezehana Hysaj, Mr se Naim Berisha, Mr se Muhamet Shabani, Mr se Leonora Laçi, Mr se Lirie Kurtishaj Ademi

Seanca e tretë, "Masakrat gjatë viteve 1989-1999" e kopsitur me 39 referate. Pra, gjatë tre seancave u mbajtën 85 punime të cilat do të botohen të plota në një vëllim dy gjuhësh, që do ju dërgohet organizimave drejtuese të BE-së.

Seminari ishte një maratonë e gjatë fryt i një pune, të kujdesshme hulumtuese, shkencore disa vjeçare me gjeografi mbarë kombëtare, ishte një lapidarë kujtose të thukë historike.

Seminari foli me gjuhen e dokumenteve të pa kontestuara, dëshmi të vetë protagonistëve gjithë atyre tufave ngjarjesh, që peshojnë sa masivi i Beshkëve të Nemura mbi shpatullat e Kosovës. Ajo tashëm e lirë shkruan e nuk harron, dëshmon dhe kërkon drejtësi, por jo hakmarrje. Shkruan në Pergaman 85 penda të ngjyera në gjakun e pa tharë të qindra, mijëra jetëve të masakruar në mënyrën më shtazore nga ultranacionalizmi i ndërkrjer serbo-malazias, për më se një shekull mbi një popull autokton, në trojet e veta, i moçëm sa toka që lindi. Vetëm gjatë luftërave Ballkanike, sipas burime të konfirmuar prestigjioze perëndimore, humbën jetë 250 mijë shqiptare. Për kush do të vërtetën dihet botërisht se ekspansioni sllav u shoqërua me shpërngulje dhe zhdukje të popullsisë etnike të trojeve gjithmonë shqiptare.

Shkrimtari i shquar hebre Leo Freundih me banim në Vjenë i revoltuar nga herezia etnike, racore dhe fetare, protestoi kundër zhdukjes masive të shqiptarëve. "Akuza që ulërijnë" titullohet kushtimi i tij human, duke thirr në shkretëtirë. Shikomi a keni sy me pa serbet, po vrasin shqiptaret?! Para syve të Evropës kontemporane në vitet 1912-1913, inkuizicioni serb vrau 500 000 njerëz. Leo Freundih ishte nder më të parët zëra intelektual, që jo vetëm mbajti koleksionin e gazetave të mëdha të kohës, që tregonin mbi shfarosjet pa brerje pendimi të shqiptarëve, prandaj nuk nguroj ta quante "Golgotha shqiptare". Kjo Golgotë, me baticat dhe zbaticat e saj herë të çmendura herë më kamufluara vijoj për 87 vjet pa nda. Vetëm gjatë agimit të përllindur të lirisë u dëbuan 848 000 shqiptarë nga Kosova, u vranë 15 000 persona, nga të cilët 1 500 luftëtarë të UÇK-së dhe rreth 5 000 të tjerë rezultojnë të zhdukur. Të hysh në rrëgallnën e shifrave masakruese sa të gërmosh për një kohë, të rrokulliset një mal i një kohe tjetër që merr përpara. Shoqata e intelektualëve "Trojet e Arbrit", fatlumë-

sisht tashmë ka po thuaj katërcipërisht në dorëshkrim kartën e formatuar kilometrike të masakrave shekullore serbe-malazeze nder mote gjere e gjatë trojeve tona etnike.

Kolegu Mark Palikaj dhe unë sollëm në këtë kuvendim kombëtarë temat "Vështrim historik mbi masakrat malazeze-serbe dhe qëndresën e Dukagjinit në



Shkrimtari, studiuesi e publicisti Prele Milani, N/ Kryetari i Shoqates Atdhetare "Dukagjini"

luftën e vitit 1915" dhe "Masakrat serbe dhe lufta anti Jugosllave në territorin e Dukagjinit me 1941"

Nuk folëm ne, por foli historia, u rrëfyem përmallshëm, duke i treguar njeri tjetrit dramën e mëdha të një ndarje të pa merituar.

Sesion shkencorë "Masakrat dhe krimet Serbo-malazeze në trojet shqiptare, në vitet 1912-1999", mbajtur me 18. 07. 2021, në Skenderaj u zhvillua rrafshit pa zhurmë, pa bujë me qetësi dhe lakonizëm shkencore, gjithsesi ai i ngjate një tragjedie kombëtare, me tre akte. 85 kumtesat e këtij tubimi shkencor në aspektin e humbjeve dhe dhimbjeve njerëzore, ishin 85 kroje gjaku, 85 turra qindra mijëshe kufomash martire, 85 kopshte me lule lirie dhe 850 mijë lapidarë e këngë lavdie. Kosova është rezervati më i pasur, ku gëlon gjakut martir shqiptarë, këtu mund gjesh, ende djepe thatë, ara të pa lëruara, vatha pa shtri, por jo kulla pa dëshmorë.

Dëshmoret janë palca e sistemit eshtëror të një kombi.

Lumja ti Kosove për fatosat që i fale atdheut!

Ti Kosovë fatose, jeni sistemi nervorë qendrorë i shqiptarisë. Motër, lirinë gëzoje dhe shijoj me kujdes e mendje të kthjelltë. Historia është mësuese e madhe e jetës. Tërmetet shekullore Ballkanike e kanë burimin nga përplasja tektonike turko-sllave dhe duel-arena mes islamit dhe ortodoksisë. Viktima e madhe e këtyre lëvizjeve sizmike ishin shqiptaret, por edhe vetë serbet që u shpërfytyruan në një macja nacionaliste me oreks lu-aneshe simbol i së keqes ballkanike.

Prelë Milani

Qafa e Agrit Bahi, Ndera, Lumnia Stergjyshore, por edhe marrja e kohës sonë

Në kuadrin e 111 vjetorit të Luftës së Qafës së Agrit

Këtë kapërcyell synonte të shkapërcente Shefqet Turgut Pasha dhe pastaj të fuste nënë thundër gjithë Dukagjinin dhe ti dilte siper Shkodres nga Veriu. Këtë qafë të mallkuar nuk e kapi kurrë, prandaj ishte pengu i madh dështues i Fatiut, të cilin deri tani e ndiqnin pas vetëm fitoret.

Gjatë ferrit Enverian, këtu u ndërtua ky lapidarë përkujtimore.

Pas dimrit të egër diktatorial, lulëzoi një pranverë anarkike, grabitqare dhe vandale sa nuk kurseu as gjë, as këtë pllakat historie.

Akoma ma brutalisht u hodh plotësisht

në erë edhe lapidari i Kodrës së Palçit.

Në çdo kohë ka të çmendurit dhe jashtëqitjet e veta të neveritshme, por epoka më e përmutshme se, kjo zor se gjë në historinë tonë moderne.


Kush bani keq? Askush! Kush holli gurin e fshehu doren mbi një datë të shenjët historie? Por, është po aq e turpshme të lihet për vite të tera kështu e përdhunuar, e mjerueshëm në vetminë e maleve. Edhe ahet që ju bënë pritë otomanit, pas këtij shëmtimi duket se u thanë nga mërzia. Edhe llogorja në shpatull të Agrit mbi 1300 mbi nivelin e detit thër-

ret e përbotur:

-Amanet moj ore e bjeshtës a thua u shpërta dhe u poshtërua gjaku, që më përskuqi në atë agim të bardhë lirie!?

Jemi një popull i shumëvujtur, që endemi në një mjegullnajë mes barbarisë dhe qytetërimit, por kemi edhe jo pak ngjarje lavdiplote historie. Pika e vetme ku u zbyth Shfqet Turgut Pasha në marshimin e tij gjakësor të muajit korrik të vitit 1910, është bahi, ndera, lumnia stergjyshore, por edhe marrja dhe faqja zeze e kohës sonë amorale.

Lapidari kushtuar këtij heroizmi, i shkatërruar



NUSJA ME KËPUCË DHE ÇORAPE TË GRISURA

E shumë dëshiruar, e shumë pritur dhe e shumë lenë pas dore, më në fund sikur u zgjidh fati i lidhur nyje i rrugës së Thethit, e cila u trumbetua si një mrekulli alpine me prita, mbuloje anti ortiqe, me vepra arti, me plot dekoracione panoramike të blerta të ndryshme nga struktura e ngurta të betonarmesë.

U fillua mirë me bazën dykalimshe, prerjen e shkëmbit, pastrimin inerteve dhe mos dëmtimin ambientit, por nuk u vazhdua kështu. Hilet alla shqiptare, duken sheshit te muret dhe urat e disa përroskave. Nuk di se çfarë u bë, por mbuloja rezultuan një bluf, pasi Qafë Thorja, deri poshtë në Varosh, mbi kamp gjatë dimrit,

muajve të parë pranverës dhe vjeshtues së vonë, bora dhe akulli janë gjithë pushtetshme në një vend të vobektë si ne. Në veç pak, mbi 15 km trase nisë tre sene, më parë punimet po zgjaten si qilimi i Penelopës. Nga zvarritja e punimeve, Thethi erret dhe zgjohet i pluhurosur, sikur të ishte fabrikë betoni, por falë bujarisë së reshjeve nuk ka mbetur krejt fytyrë pa larë.

Dasma e madhe ka kohë, që ka filluar, por "nusja hirplote nuk dihet se, kur do të shkelë mbi tapetin e kuq". Pak gjasa ka të vijë edhe këtë vjeshtë, por duke parë pajën e saj do vijë me këpucë dhe çorape të grisura.

Muret mbrojtëse me prita plastike rezultoi një dështim trashanik i shëmtuar dhe skandaloz. Në më shumë se, 65 të gjatësisë së pritave plastike, dimri më i parë i nxori fiasko. Nuk ka nevojë të jesh inxhinier as gjeolog, por çdo kush që ka sy sheh se një skrapatë nga 3 deri 7 metra me formacione flishore të paqëndrueshme nuk mbrohet nga shembja me bajga cikloprike. Nuk mund të bëhet trase më qeska plastike, lidhëse najloni në një zonë shpatull pjerrët me reshjet më të larta në Shqipëri (veç Boga i qëndron në krah), me shtresë bore mesatare 1, 5-2 metër dhe me temperatura deri -20 C. Nëse kjo rrugë merret në dorëzim, me këto vepra arti dhe mure mbrojtëse, këtë vjeshtë, në pranverë do shihini një zonjë me brekë skurliqur, me ushkurë nëpërkëmbë.

Bashkësia e Thethit heshti, me navitet dhe kurrë nuk u artikulua një zëri se, nuk ka turizëm funksional dhe plotë

në këtë rajon, pa u lidhe me asfalt rruga e Dukagjinit në dy krahët. Bashkësia e Thethit nuk duhet tregohet kaq miop sa të mos shohë armimet e shëmtuara të mureve plastike, të cilat nuk japin as një garanci për një rrugë normale nesër.

Lidhja Alpe -Adriatiku (Dukagjin-Malësi e Gjakovës-Kosovë) kurrë nuk u fut në projektet e qeverive shqiptare tash një 100 e sa vjet, ndërkohë që austriaket dhe italianët erdhën si pushtues, qëndruan fare pak dhe lanë pas dy projekte të shkëlqyera plotësisht të mundshme, me rendësi ekonomike, turistike dhe mbarëkombëtare. Detyrim dhe përgjegjësi ka edhe qeveria e Kosovës, ndërkohë që bijtë e alpeve duhet të kërkojnë me detyrim përcaktim realizimin e një projekti të tillë qeverive të dy vendeve të njëjta.

Prele Milani

Tonin Prela kampion kombëtar, në boks

Me datë 11 korrik 2021, në Vlorë u zhvillua kampionati Kombëtarë i Boksit për moshën U-16. Në peshën 60 kg, kampion Kombëtar u shpall Tonin Prela, nga fshati Lotaj i Shalës. Gjithashtu, boksieri Prela, u shpall edhe boksieri më i mirë i Kampionatit.

Me këtë sukses të këtij biri të Dukagjinit, vijohet tradita e nxjerrjes së sportistëve të spikatur në arenën Kombëtarë nga zona e Dukagjinit.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", duke u ndjerë krenar për këtë përfaqësim me indentit të zonës tonë, i urojmë suksese të mëtejshme dhe një karrierë të mbushur me trofe talentit Tonin Prela.

Av. Anton Kosteri



Qendresa e Dukagjinit në Plan

- Në kuadrin e 106 vjetort të saj -

Me 15 Korrik 2021 në Njësinë Administrative Pult, është organizuar “Përkujtimorja e Qereshit”. Përkujtimi i luftës së popullit në Planit, 106 vjet më parë kundër pushtuesit serbo-malazez, program artistik, promovimi i resurseve të krahinës dhe eksplorimi i bukurive natyrore, panairi i produkteve ushqimore të traditës, ishin veprimtarite që pasuruan këtë moment.

Deputetja Greta Bardeli në fjalën e saj veçoi rendesin e kesaj date dhe vlerat e krahinës, e cila dallohet për historinë, vlerat historike dhe resuset e panumerta të saj. Në vjimesinë e punës së saj Deputetja në fjale mbetet një dorë e fuqishme, që premt për ndryshime rrenjsore të kesaj zone.

Fjalimet e njepasnjeshme të Nenkrutarit të Bashkisë Shkoder, Tonin Deda, Administratorit Tom Markut e të tjerë, shpalosen vlerat historike, natyrore dhe artistike të krahinës. Kjo feste e mirë organizuar mbetet një kampanë që jehonë në mesin e bjeshkve jo vetem me perkujtimin e heronjve që derdhen gjakun për keto bjeshke, por si një rikthim i jetes në kete Parajse natyrore.

Falenderim për të gjithë organizatorët, por në veçanti kryplakun e Planit, Petrit Rushaj, Leken, Gjeloshin, Noshin, Mirashin e deri tek brezi i tretë i kesaj familje, Jasonin dhe Armandon.

Lavdi Deshmorve dhe lunturi dhe Paqe popullit të Pultit!

Roza Pjetri



Deputetja Gerta Bardeli



N/kryetari i Bashkisë Shkoder, Tonin Deda



Administratori i Pultit, Tom Ndoka



Këngëtarët Ndue Shytani e Fran Kodra

Rikthehet pas katër vitesh, malësori shqiptaro - amerikan Gjon Frani Ivezaj të dëshmojë për Rrënjët dhe Malet e Malësisë së Madhe

Ditën e premte, me datën 23 korrik 2021 në ambientet e Bibliotekës “Marin Barleti” të qytetit të Shkodrës u organizua një veprimtari kulturor me tematikë “takim me lexuesin”, ku miku i kahershëm i kësaj biblioteke, Profesor Gjon Frani Ivezaj promovoi njëherazi dy librat e tij të fundit “Iliro Paganët dhe Sfidat e Krishterimit në Shqipëri” si dhe “Rrënjët dhe Malet e Malësisë së Madhe”.

Realizimi i kësaj veprimtarie u bë nën kujdesin e veçantë të drejtorit të bibliotekës z. Maxhit Cungu dhe monitorimin profesional të znj. Linda Doda-Kavaja.

Në këtë veprimtari, si kurrë më parë morën pjesë studiues, historianë, analistë, shkrimtarë, poetë, gazetarë dhe mjaft lexues ndër ta edhe të rinj gjimnazist, të cilët i dhanë ende më tepër kuptim tematikës “takim me lexuesin” si një nevojë e munguar së fundmi, për shkak të pandemisë.

Në respekt të Prof. Gjon Frani Ivezaj dhe punës së tij kërkimore shkencore disa vjeçare, të finalizuar në këta dy libra, morën pjesë edhe përfaqësues institucionesh nga qytetet e Shkodrës, Koplikut, madje edhe nga Mali i Zi e Kosova, të cilët i dhanë edhe më shumë seriozitet kësaj veprimtarie.

Për të pranishmit fjalën përshëndetëse si dhe prezantimin e këtyre dy librave të shoqëruar me një biografi të autorit e mbajti Drejtori i Bibliotekës z. Cungu, i cili mori edhe vëmendjen e plotë të pjesëmarrësve falë kuriozitetit që kishin shfaqur edhe më herët për ta njohur nga afër këtë autor malësor nga diaspora.

Një vëmendje ende më të madhe mori analiza e hollë dhe plot profesionalizëm shkencor e studiuesit dhe historianit Prele Milani, i cili i vlerësoi këta dy libra si një punë e mirëfilltë shkencore, duke pohuar edhe saktësinë e autorit në konstatimin e ngjarjeve dhe fakteve që lidhen me ndriçimin e historisë që nga antikiteti e deri në mesjetën e vonë.

Gjithashtu ai u ndal edhe në disa pika kyçe, të cilat ende dhe sot shihen si ngërç të pengmarrjes së pranimin të të vërtetave historike, që lidhen me organizimin fisnor apo nocionin e Bajrakut, të cilat sipas tij autori i kishte shtjelluar me shumë kujdes dhe mjaft saktë.

Lidhur me këto punime për të pranishmit folën edhe studiues e kritikë si Rita Shkurtaç, Kadri Ujkaj e të tjerë, të cilët dhanë gjithashtu vlerësimin e tyre për punën e z. Ivezaj. Nuk munguan as diskutimet e lira si dhe respekti ndaj autorit ku veç fjalës përshëndetëse z. Ndue Sanaj i dhuroi librin e tij të fundit “Dukagjini- Shqipëria ime aty” si shenjë mirënjohje ndaj tij.

Në respekt dhe mirënjohje për të pra-



nishmit mes emocioneve dhe gëzimi për vlerësimin e punës së tij dhe surprizimin nga prania e shumë të intelektualëve dhe pjesëmarrësve në sallë, si dhe

mediave lokale përshëndeti dhe falënderoi përzemërsisht pjesëmarrësit, duke i dhënë secilit një emocion të shtuar, që vetëm mërgimtarët dinë ta peshojnë dhe


kuptojnë mallin dhe dashurinë ndaj At-dheut dhe të qenurit në mes të bashkatdhetarëve.

Një pikë lot malli mbi buqetën me lule të njoma, dhuruar autorit nga “njomëza shkodrane” Aislin Kavaja ishte momenti më emocionues që mori edhe shumë duartrokitje.

Në emër të autorit dhe Bibliotekës “Marin Barleti” të pranishmit i falënderoi znj. Linda Kavaja, e cila moderoi edhe ecurinë e veprimtarisë.

Në fund, veprimtaria u zhvendos në një bar-kafe, në të cilin vijuan mendime e diskutime të lira dhe vëllazërore mes autorit dhe pjesëmarrësve nën shijimin e kafes dhe nënshkrimit të autografeve mbi libra, dhuruar nga autori.

Rita Shkurtaç, Korrik 2021



Martin Camaj përherë me ne

- Redaksia e boton këtë bashkëbisedim të kuadrin e 96 vjetorit të lindjes -



Nga Ardian Klosi

Sot, shkrimtari dhe linguisti Martin Camaj do të kishte mbushur 85 vjeç. Në dy vjetët që do të kalonin deri sa vdiq, Camaj luajti një rol të jashtëzakonshëm në jetën tonë. Ai ishte shembulli i gjallë i qëndresës në fushën e kulturës.

Botojmë sot për herë të parë bisedën në një talk-show të Televizionit Austriak, në Mars 1991 ku Camaj ndodhej përballë një ambasadori që mbronte vijën e PPSH-së

Sot, shkrimtari dhe linguisti Martin Camaj do të kishte mbushur 85 vjeç. Një moshë e zakonshme mund të thash për malësorët e tij të Dukagjinit, sidomos për një njeri aq të përkorë si profesori i Munihut. Por sëmundja e rëndë që i qe shfaqur që para se të mbushte të 65-at i rrëmbeu jetën më 12 mars 1992.

Ai e dinte shumë mirë që do të vdiste, edhe kur jemi takuar për herë të parë në Innsbruck në shkurt të vitit 1990, mandej shumë herë e ka tematizuar vdekjen në poezinë e tij (Kur të vdes më mbështillni me tesha të leshta/sikurse ishte dokja ndër të parët e mi) ndërsa vitet e fundit ndërtoi me të një parabolë të tërë në formën e një cikli poetik, për mendimit tim nga më të mirët në gjithë veprën e tij: "Palimpsest".

Takimin e parë me Camajn e kam përshkruar edhe në raste të tjera. Ai erdhi në Innsbruck me shpresën që një poete lokale e atyshme të lëmonte do përkthime të dobëta nga shqipja të poezive të tij.

Unë isha duke mbyllur studimet e mia në atë qytet. Na e ndërhmjetësoi takimin albanologu i Innsbruket Hermann Oelberg, njeri që kishte mbledhur në bibliotekën e Institutit të tij shumë literaturë subversive për Shqipërinë e që kërkonte me të herë pas here të më thyente frikën.

Subversive në pikëpamje letrare ishte vepra e Camajt, e plotë në vël-

lime të mëdhenj të bukur me ngjyra të thekshme nën motivet e Gjeloish Gjokajt, e vështirë për t'u depërtuar me skemat që kishim ne në kokë aso kohe lidhur me vlerat dhe hierarkitë në letërsinë shqipe. Por një herë që të kishte pushtuar magjia e gegnishtes dhe poezisë së tij, ajo nuk të lëshonte më.

Misteri që fshihej në shumë nga ato poezi, abstragimi i tyre i lartë, të bënte t'i ktheheshe e riktheheshe si ndonjë gote magjike me verë që mbushet vetiu. Ishte një botë gjithë ngjyra që nuk pranonte emërtime të caktuara, si mëngjese të largëta fëminije, ku gjithë sendet dhe njerëzit përreth kanë kuptim të thellë e të vërtetë.

Vetë Camaj ishte tejet i përzemërt, me një mirësi të kultivuar, kur bashkohej malësori bujar me evropianin erudit. Zëri ishte tejet melodioz, dukej nganjëherë sikur fliste me kantilenë, e nuk e di si këndonte por do çuditesha sikur të mos këndonte bukur me atë zë dhe nuancat e holla që shqiptonte. Sidomos gjermanishten e kishte të kulluar, fjalët të nyjëtura saktë me një tingëllim Shkodre për të cilin më duket ishte krenar.

Ashtu sikurse Bogdani erdhi në Shkodër për të lëmuar kosovarishten e vet ("m'anshtë dashunë me djersë të mëdha shumë fjalë me ndërequnë ndë dhe të Shkodërsë") edhe Camaj kishte marrë tingëllimet më të bukura të qytetit të tij, ku pat zbritur dikur fëmijë nga Temali i Dukagjinit për t'u shkolluar në kolegjet e jezuitëve.

Për çudi atë ditë të ftohtë dimri një numër fjalish në shqip i linte të pambaruara, kalonte prej një teme te tjetra, a thua se e nguste diçka ose pse e ndjente pamundësinë që në kohën e mbetur të kumtonte të gjitha sa donte (midis nesh 45 vjet mungesë komunikimi).

Erika e shoqja, ndërhynte herë pas here për ta sjellë te tema për të cilën kishin ardhur. Unë në fillim, në ndikimin e sa e sa romaneve si Armiqtë ose Mërgata e korbave e kushedi sa filmave të Kinostudios Shqipëria e Re, e ndjeja që kisha përballë armikun klasik (aq më shumë që Camaj shtatlartë kishte veshur një pardesy të çelët dhe e kishte ngritur jakën mbi qafë ngaqë në luginën e Innit frynte erë e fortë).

Por tundimi për ta njohur ishte shumë më i madh se frika, e pastaj kur sheh se ky njeri merret me kulturë dhe poezi të rafinuar dhe jo me diversion, skemat e Kinostudios kthehen në libra për fëmijë të prapë.

Në dy vjetët që do të kalonin deri sa vdiq, Camaj luajti një rol të jashtëza-

konshëm në jetën tonë.

Ai ishte shembulli i gjallë i qëndresës në fushën e kulturës, vijuesi i një tradite të pandërprerë në poezinë shqipe të variantit gegë që megjithatë kishte hyrë në terrene të pashkelura më parë nga krejt poezia jonë, duke u afruar me motrat më avangarde në kontinent, pa e humbur karakterin e saj shqiptar, përkundrazi me rrënjë shumë të forta në mitologjinë dhe mënyrat shprehëse të Veriut. Camaj ishte shembulli i gjallë edhe i qëndresës në gjuhë.

Ndërsa të tjerët luftonin me pamflete ose teorizime që nuk i dëgjonte njeri, ai e tregoi me vepra të shumta në poezi, në prozë ose dramaturgji se një traditë aq e gjatë letrare nuk mund të vdesë brenda një brezi, edhe pse për këtë qe vendosur më 1972, në kushtet e diktatit nga lart, prej shumicës së përfaqësuesve të asaj që ishte kultura zyrtare e kohës.

Këtë qëndresë ai e zhvilloi edhe në shinat e dijës, me monografi e gramatika të ndryshme, sikurse në Albanian Grammar të tij ku e analizon gjuhën shqipe në tri koinetë kryesore të saj: gegënisht, toskërisht e arbëresh.

Pak për t'u habitur sot, kur Camaj pranohet nga gjithë përfaqësuesit me peshë e me poste të gjuhë-letërsisë shqiptare, kjo anë e personalitetit të tij lihet në heshtje, madje Camaj ngrihet lart më fort nga të gjithë pikërisht prej atyre që nuk duan as t'i dëgjojnë termat gegënishte ose variant letrar gegë.

Camaj pati për ne një rol të veçantë edhe si frymëzues për njohjen dhe përhapjen e kulturës së panjohur ose deri më aty të ndaluar shqiptare në Shqipëri.

Në qershor 1991 krijuam Lidhjen e shkrimtarëve e intelektualëve të pavarur "Albania" që e pati pikërisht këtë si synim kryesor të saj: në disa botime të atyre viteve si "Shqipëria zgjim i dhimbshëm", "Libertas", "Quo vadis Shqipëri" e të tjera.

Martin Camaj dhe Arshi Pipa ishin nga kontribuesit kryesorë. Pak ditë para se të vdiste i dërgoi me telefon lidhjes sonë këtë mesazh që u bë më pas i famshëm për fjalinë e tij të fundit:

"Të dashun miq e vllazën shqiptarë, intelektualë, artistë dhe mbarë popull shqiptar, përshëndetjet e mija ju janë drejtue të gjithëve. Gëzohem pa masë se keni vendosë të vlerësoni veprën time: ky vlerësim na afron. Bâtë burrninë të më shtini në rreshtin tuej. Ndonse të ndamë për një gjysmë shekulli, unë jam i jueji e ju jeni të mijt. Martin

Camaj."

Në ditët që pasuan rrëzimin e monumentit të Enver Hoxhës në Tiranë jemi takuar me Camajn në studion e Klub 2, një nga talk-show kryesorë të Televizionit Austriak. Ishin ftuar këtu gjithashtu historiani M. Schmidt-Neke, gazetaria Ch. von Kohl, ambasadori i atëhershëm i Shqipërisë në Vjenë, zëdhënësi i Partisë Demokratike Genc Pollo.

Camaj u tregua edhe këtu i qetë e i matur, me gjithë ndërhyrjet e vrazhda e provokuese të ambasadorit që mbronte natyrisht vijën e PPSH e që arriti deri aty sa t'i thoshte tërthorazi Camajt se i paskej duart e lara me gjakun e popullit.

Apo ndoshta Camaj u tregua i përmbajtur se, mendonte që mund të hakmerreshin ndaj familjes së tij në Temal, ndaj të vëllezërve Gjergj e Zef që jo pak kishin vuajtur qysh prej arratisjes së tij më 1948? Midis Camajt dhe ambasadorit botë kulture.

Mjaft të vëreje gjermanishten e latuar me kantilenë Shkodre të profesorit dhe fjalitë e rrëmujshme të tjetrit për të bërë dallimin. Sidoqoftë nxora nga kaseta e emisionit të atëhershëm ato fragmente ku ka folur Martin Camaj dhe dialogun që është zhvilluar mes të dyve:

Nga emisioni për Shqipërinë në Klub 2 të Televizionit Austriak, më 2 mars 1991:

Moderatori: Cili është versioni juaj, zoti ambasador [për rrëzimin e monumentit]?

Ambasadori: Unë përfaqësoj këtu si ambasador një shtet dhe një qeveri. Dëgjova këtu çfarë thanë dy zotërinjtë, zoti Klosi dhe zoti Pollo, për mua nuk është asgjë e re. Studentët ishin futur në grevë urie, kishin kërkesa të tjera të cilat pjesërisht u përmbushën. Duhet të theksoj se nuk ishin aty të gjithë studentët, nuk është nevoja të përgjithësohet kështu. Në grevë urie ishin rreth 700 studentë. Pastaj, thonë, se u bashkuan me ta edhe punëtorë. Por për mendimin tonë fjala nuk është thjesht për një ose dy monumente. Ekzistojnë forca në Shqipëri që duan të pengojnë zhvillimet demokratike, janë forca regresive, rebele, nëse mund të shprehem kështu, janë forca të errëta që provokuan direkt.

Moderatori: Ju thatë forca të errëta, regresive, cilët keni parasysh me këto?

Ambasadori: Janë forca të errëta. Siç tha dhe zoti Pollo, po të kishte ndërhyrë policia, do të ndodhte gjakderdhje. Këtë dëshironin forcat e errëta. Ka ligje në Shqipëri, ka një

ligj greve, që u shkel, ka një ligj për demonstratat, për të cilin kanë rënë dakord të gjitha partitë, që deri në zgjedhje nuk do të ketë demonstrata. Të gjitha këto u shkelën. Ka një ligj për mbrojtjen e monumenteve, edhe për mbrojtjen e emrit të Enver Hoxhës. Unë nuk do të flas këtu për arritjet dhe meritat e Enver Hoxhës, nuk është ky qëllimi im. Dua të them vetëm se me aktin që u krye aty, u luajt me ndjenjat e popullit. Dhe pikërisht këtë donin të arrinin.

Christine von Kohl: Po kush ishin këto forca?

Ambasadori: Sikur ta dija unë... Por ka të ngjarë të dalë, me siguri.

Moderatori: Siç e kuptoj unë, gjatë vitit të kaluar qeveria e Ramiz Alisë ka bërë përpjekje që me hapa të vegjël të shkohet drejt demokracisë. Këto forca tani duan të shkaktohet gjakderdhje dhe të pengohen reformat, apo jo?

Ambasadori: Më lini ta mbaroj mendimin. Pas këtij incidenti të gjitha partitë politike, edhe Partia Demokratike, i dënuan këto akte kriminale, që janë penguese për procesin e demokratizimit në Shqipëri dhe duan të çojnë në luftë civile. Këtu ka një kundërtënie. Zotërinjtë këtu, si përfaqësues të Partisë Demokratike e përshëndetën këtë akt, nga ana tjetër zyrtarisht ka një deklaratë të kësaj partie që i dënon këto akte.

Martin Camaj: Shtjellimet tuaja zoti ambasador, më tingëllojnë shumë të errëta, kurse këto forcat e errëta më tingëllojnë mistike, mistifikim i fakteve. Edhe diçka që më ka bërë shumë përshtypje, sidomos me rrëzimin e Enver Hoxhës, si letrar: figura e Enver Hoxhës – për ne jashtë Shqipërisë, e unë përfaqësoj në njëfarë mënyre këtu diasporën – është paraqitur si një njeri i dashur, të cilin e adhuron gjithë populli. Kështu nga një person real u krijua një person fiktiv, i cili gjeti pasqyrimin e vet pastaj edhe në letërsi. Sipas ndjesisë sime ky rrëzim është diçka simbolike, diçka që e ka prituri i gjithë populli shqiptar prej 45 vjetësh. Shtjellimet tuaja (i drejtohet ambasadorit) për demokracinë më duken mjaft të dyshimta, që një bartës, një flamurtar i diktaturës të udhëheqë demokratizimin.

Kjo është një contradictio in termines, që një diktaturë, me policinë, me të gjitha strukturat e saj, të qenkej në gjendje të realizojë demokratizimin në Shqipëri ose ta ndihmojë atë.

Unë jam një emigrant i vjetër, ju natyrisht mund të thoni që unë paraprakisht jam një armik, emri im deri më sot ishte krejt i ndaluar në Shqipëri, po të më kishit parë para e zëmë tetë muajsh, ju me siguri nuk do të ma kishit dhënë dorën, sikurse ka ndodhur shpesh.

Por dua të jem me të vërtetë objektiv. Pra, unë nuk besoj që Partia e Punës së Shqipërisë të jetë në gjendje të udhëheqë proceset e demokratizimit në Shqipëri. Jam shumë i gëzuar që

sonde kemi këtu këta dy zotërinj, përfaqësues të brezit të ri dhe unë besoj se brezi i ri sot, që quhen demokratë, se vetëm këta janë në gjendje të realizojnë një demokratizim të vërtetë në Shqipëri.

... **Moderatori:** Duket e pamundur që dikush në vendet e Lindjes që udhëheq një parti, që është i rrethuar nga shokët e partisë të jetë në gjendje të realizojë me shkathësi reforma. Shembulli më i mirë është Gorbaçovi që filloi perestrojkën dhe që sot sheh para vetes gërmadhat e perestrojkës.

Martin Camaj: E vërteta është që qysh prej 1945-s e deri më sot në Shqipëri nuk janë realizuar reforma. Ky është ndryshimi nga partitë e tjera komuniste të Lindjes. Edhe Jugosllavia, madje edhe Rumania, kanë njohur shkallë-shkallë disa reforma. Në qoftë



se kuptohen me reforma grindjet në majat e partisë, kjo është diçka tjetër. Kurse reforma të vërteta, të natyrës ekonomike, pse jo edhe në arte... Realizmi socialist është gjithmonë konstant – kemi një vijë të drejtë nëpër kongreset e partisë, të themi që nga 1948 e deri më sot është gjithmonë po një vijë e drejtë, e patrazuar, pa reforma.

Ambasadori: Në qoftë se ju thoni vetëm një vijë e drejtë, pse jo, ju i keni kthyer kurrizin Shqipërisë, por edhe jeni shumë larg që ta ndiqni Shqipërinë nga Munihu. Reforma ka pasur edhe te ne. Kur flitet për procesin e demokratizimit te ne duhet bërë dallimi me vendet e tjera.

Procesi i demokratizimit te ne ka filluar para një viti, atë e ka nisur presidenti Ramiz Alia duke pasur mbështetjen e partisë, ku është sekretar i parë, por edhe të masave të popullit. Ndryshimi është që ka disa që kërkojnë që ky proces demokratizimi të zhvillohet shumë shpejt. Por brenda një kohe të shkurtër u arrit edhe liberalizimi i mendimit edhe pluralizmi i partive. Edhe në të drejtat e njeriut ka

arritje. Edhe në ekonomi.

Moderatori: Domethënë ka përpjekje për demokratizim që prej një viti. Por fjala është për më përpara, që nuk ka pasur diçka të tillë, këtë po thonit ju apo jo (i drejtohet Camajt)

Martin Camaj: Kjo është e vërteta.

Dhe nuk është e vërtetë që flasim me përafërsi. Dihet që në Gjermani, sidomos në universitete, si për shembull në Munih, ka specialistë të mirë që janë marrë me problemet shqiptare. Munihu është qendër për studimet e Evropës Juglindore, kështu ka specialistë për ekonominë nga Instituti i Ekonomisë, politologë e të tjerë.

Natyrisht të dhënat janë marrë nga „Zëri i Popullit” dhe literatura juaj. Studiuesit kanë qenë përgjithësisht të rinj që e njihnin mirë gjuhën shqipe. Natyrisht e pranoj që ka munguar at-

tregoheni shumë misterioz. Ju i njihni ligjet...

Ambasadori: Ata që nuk i kanë ndyrë duart me gjakun e popullit, që nuk kanë luftuar kundër popullit, me përjashtim të tyre të gjithë të tjerët lejojnë

Moderatori: Ndiheni i prekur ju nga kjo, zoti Camaj?

Martin Camaj: Jo.

Moderatori: Domethënë mund ta bëjë kërkesën në Bonn.

Ambasadori: Sigurisht.

Martin Camaj: Më mirë po pres edhe pak derisa këta të dy (tregon nga Klosi dhe Pollo) të vijnë në pushet. Unë jam një tjetër gjeneratë, por identifikohem me gjeneratën më të re. Këto janë çështje personale dhe jo fort të rëndësishme.

E rëndësishme është ajo që kam vënë re, që familja shqiptare, struktura e familjes shqiptare është e tronditur. Kjo është shumë keq për një shoqëri që nuk është shkëputur ende nga patriarkati.

Ka edhe probleme të tjera, p.sh. ajo çka më bën shumë përshtypje dhe më brengos, sidomos kur hyj në bisedë me emigrantët e rinj, mësoj se në një shoqëri të ashtuquajtur, teorikisht, pa klasa, ka të privilegjuar, më pak të privilegjuar, pastaj është masa, masa që mban ekonominë, pra makineria prodhuese, dhe edhe sot, në vitin 1991, ka të deklasuar.

Ambasadori: Ç’do të thotë të deklasuar?

Martin Camaj: Të deklasuar? Domethënë që nuk kanë të drejta, nuk kanë prestigj... ju e kuptoni mirë ç’do të thotë të deklasuar.

Ambasadori: Po kë keni ju parasysh me këtë?

Martin Camaj: Për shembull çdokënd që ka qenë një herë në burg. Ose priftërinjtë, hoxhat, e gjithë kategoria e tyre, me aq sa jam i informuar, këta përbëjnë një klasë të deklasuar-ish...

Më dt. 6.3.1991 Camaj i shkruante një letër Gjon Sinishtës në universitetin e San Franciskos, botuesit të Buletinit Katolik Shqiptar. Ndër të tjera i tregonte për emisionin “Më 2 marc, javën që shkoi isha në Vjenë ku u mbajtë në televizionin austriak një talk-show mbi Shqipërinë... Klosi e Pollo mbajtën anën time në diskutim: ambasadorin e bëmë pupletë derisa iu muer goja, si belbacakut. Ashtë e para herë që dal e diskutoj në një talk-show dhe e kalova provimin.”

ARDIAN KLOSI,
magjia e gënishtes,
Martin Camaj, profesori i Mynihut

mosfera, hollësitë, por konturet e krejt zhvillimit, këto janë regjistruar dhe hulumtuar.

Kështu janë nxjerrë përfundime, janë botuar monografi... (Pas disa shpjegimeve nga A. Klosi për fetë tradicionale të shqiptarëve, kanunin, periudhën ateiste, zbrazëtinë morale dhe dëshpërimin që shprehet me eksodin, Camaj ndërhyr:)

Martin Camaj: Për sa i takon etikës, moralit, kodeksit, jetës që ka bërë më parë populli shqiptar, dua të ngre një çështje. Meqë ambasadori thotë se unë kam një kohë të gjatë larg...

Moderatori: Më falni, a do të ktheheshit tani?

Martin Camaj: Natyrisht.

Moderatori: Dua të them, a ju lejojnë?

Martin Camaj: Nuk e di...

Ambasadori: Po ju e njihni Shqipërinë, ju e ndiqni zhvillimin në Shqipëri, ligjet, ju i njihni ligjet.

Martin Camaj: Unë desha të ngre një çështje...

Moderatori: Më falni, zoti ambasador, mund t’ju ndërpres sepse po

Veprimtaria e VIII e Ditës së Plisit të Bardhë

Në Kosovë për 8 vite me radhë mbahet një manifestim tradicional kulturor, i cili është pagëzuar "DITA E PLISIT".

Këtë vit, veprimtaria e VIII e tij, u mbajt në Stankaj të Rugovës, në kullën e Hysen Kurtajt (lahutari i njohur). Manifestimin e drejtoi, ideatori Ismet Krasniqi, me bashkëpunëtorët e tij, Shkrimtarin Prend Buzhala, Piktorin e poetin Idriz Bersha e Poetin e skulptorin Gjon Gjergjan.

Ndërmjet kumtesave nga të pranishmit pati edhe pika muzikore nga rapsodët: Rifat Berisha me grupin e tij, Gjon Krasniqi (diasporë, SHBA), Nazmi Hajdari dhe me lahutë, Hysen Kurtaj, rapsodi Gjeloš Fusha, Ansambli "Rugova", e të tjera.

Grupi i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" i përbërë nga Ndue Sanaj (Kryetari), Anton Kosteri (Sekretari), rapsodi Gjeloš Fusha, anetari i SHAD, Zef Kosteri dhe poeti, publicisti e redaktori i gazetës "Dukagjini", Lulash Brigja, mori pjese në këtë veprimtari.

Me këtë rast, njeri nga grupi organizator, shkrimtari Prend Buzhala, mbajti kumtesën, me temë: "Kulti nderit në raditën shqiptare".

Përhëndeti dhe Ndue Sanaj, në emër të grupit pjesëmarrës dhe në mes të tjerave u ndal: "Mendoj të largohemi nga mendësia, "Ai e ka fajin". Sa kohë të vijomë me këtë mendësi, asnjëherë nuk do të dimë se kush jemi. Vërtetë zotëria tha: "Në muzeun, në Zvicër vendosa lahutën, por askush nuk tha gjë, askush nuk foli nga shqiptaret ...!? Të nderuar, sot po paraqesim dhe librin e VII të Ditës së Plisit të Bardhë, se të VII veprimtaritë e zhvilluara deri tani, se cila janë shkruar e botuar në një libër dhe nesër do të botohet dhe kjo veprimtari, veprimtari e VIII. Në qoftë se organizatorët, më në krye Ismetin, nuk do të shkruanin në një libër veçmas secilën veprimtari, askush nuk do ta njihje. Do të thoshin, se një grup nga Klina kanë organizuar Ditën e Plisit të Bardhë, por më tej jo... E theksova këtë, çka shkruhet mbetet e të tjerat i marre era. Ne duhet ta ndajmë mendjen, se po nuk e ndave mendjen ajo hallakatet dhe siç thekson kuksiani "shto miell e shto ujë, bëhet buka e tjetër kujt". Zotëri përse kemi inate dhe deri në urrejtje, se tjetri fiton?! Por, nga ai që fiton nuk duhet pasur urrejtje, por duhet pasur angazhim, që edhe unë të punojë e të fitojë. Më falni, se e zgjata pak, por dhe njëherë dua të theksoj: "Të heqim mendësinë e gabuar, ai e ka fajin se, me këtë mendësi asnjëherë nuk do të dimë se kush jemi!"

Me propozim të grupit organizator, më në krye aktorin Ismet Krasniqi, kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" u fut në punë dhe vendosi të nderoj me tituj nderi disa nga artistet, shkrimtarët e dëshmoret:

Me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", profesor dr. Zymer Neziri dhe veprimtarit e hulumtuesit Frrok Kristajn;

Me titullin "Mirënjohja Mehmet Shpendi", avokatin dëshmorë të atdheut, Bajram Kelmendi, pas vdekjes;

Me titullin "Mirënjohja Martin Camaj", profesor dr. Tahir Bezhani e Sejdi Berisha dhe poetin Gjon Gjergjan.

Më vonë pati "Orë letrare", në nderim të manifestimit, lexuan poetët: Rrahim Sadiku, Lulash Brigja, Agim Desku, Idriz Berisha, Raif Gashi, Gjon Gjergjaj, Safet Hasani, Gani Bytyçi, Maxhun Osmanaj, Halil Xani, Ragip Kçiku, Ramë Thaçi, poezi kushtuar Ditës së Plisit të Bardhë.

Pas manifestimit në oborr të kullës, pati ushqime tradicionale, valle, foto biseda bashkëpunimi. Disa media televizive e përcollën këtë veprimtari, por në mënyrë të veçantë, miqtë e tone të TV FONTANA, me Zeqir Mehmetaj.

Respekt për organizatorët dhe pjesëmarrësit edhe pse pak larg dhe koha e pamjaftueshme për të shijuar bukuritë e beshkës, ishte kënaqësi mbresëlënëse pjesëmarrja e jonë.

DISA OPINIONE

Ismet Krasniqi-Lala



Këshilli Organizativ i manifestimit "Dita e Plisit" falënderon Shoqatën Atdhetare "Dukagjini" me qendër në Shkodër për nderimin me tituj nderi disa individëve plis bardhë. Kryesia e kësaj shoqate, pasi u dha propozimi nga ideatori i manifestimit "Dita e Plisit", për dhënie e titujve të nderit të disa personaliteteve të shquara të artit, kulturës, trashëgimisë e lartësisë, me datën 23 qershor 2021, vendosi:

Ndarja e disa titujve nderi "Mirënjohjeve nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini" Shkodër, pasi u dha propozimi nga ideatori i manifestimit "Dita e Plisit" z. Ismet Krasniqi për dhënien e titullit të nderit disa personaliteteve të shquara të artit, kulturës, trashëgimisë e letërsisë, kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" me datën 23 qershor mori vendim me sa vijon :

Një nga personalitetet e sotme me të fuqishme të studimiologjisë të epikës dhe lahutës shqiptare prof. Dr. Zymer U. Neziri i jepet titulli i nderit "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini" dhe Frrok Kristaj, studiues dhe promovues i trashëgimisë kulturore e shpirtërore bërë gjatë gjithë veprimtarisë së tij mbi gjysmë shekulli në fushën e trashëgimisë kulturore e shpirtërore në Zym të Hasit;

"Mirënjohja Mehmet Shpendi", avokatit dëshmorë Bajram Kelmendi, pas vdekjes;

Shkrimtarit, poetit, autorit të shumë veprave letrare, publicistike e monografi, fitues i shumë Çmimeve, Sejdi Berisha i jepet titulli i nderit "Mirënjohja Marin Camaj";

Tahir Bezhani, poet, shkrimtar, autor

i shumë librave, kontribut të veçantë ka dhënë në publicistik me anë të shkrimeve të ndryshme, fitues i shumë çmimeve në letërsi i jepet titulli nderit "Mirënjohja Marin Camaj"

Gjon Gjergjaj, poet, shkrimtar, skulptor, artist dhe koleksionues i trashëgimisë shpirtërore e materiale, veçohet Muzeu "Agimet e Gjytetnisë", i jepet titulli nderit "Mirënjohja Martin Camaj".

Dhe njëherë, falënderojmë kryesinë e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për vlerësimin e propozimit tonë, për bashkëpunimin në mes nesh, në mes shqiptareve.

Tahir Bezhani

Në Stankaj të Rugovës, rrethuar me bukuritë e rralla të atij relievi beshkor, nën freskinë e ajrit të pishave të gjata naimiane, me prezencën e shumë personaliteteve të jetës kulturore të trojeve tona, u mbajt manifestimi i tetë nga trashëgimia



jonë,"Dita e Plisit", një veprimtari kulturor me përmasa mbarë kombëtare.

Dje në Stankaj, ishte e vogël oda e burrave në kullën e rapsodit Hysen Kurtaj, për t'u vendosur afër njëqind burra nga shumë vende në shtrirje kombëtare, duke u nisur nga Shkodra, por edhe diaspora, ku kishin ardhur shumë intelektualë në këtë manifestim të përvitshëm kulturor në vendin tonë. Ideatorët e këtij manifestimi, Ismet Krasniqi-Lala, letrarët Prend Buzhala, Gjon Gjergjaj, Idriz Berisha e të tjerë intelektual të spikatur nga Klina, kishin bërë organizimin në mënyrën më të mirë të mundur, ashtu që pjesëmarrësit të ndiheshin sa më komod gjatë këtij manifestimi. Dje në Stankaj, në dhomën e burrave të kësaj kulle guri, e cila dukej më e bukur se ajo e Ejfelit në Francë, nga se ishte mrekulluar nga mënyra e përgatitjes dhe pritjes së mysafirëve. Të gjithë të pranishmit mbanin plisa të bardhë në kokë, ulur sipas traditës, duke respektuar njëri tjetrin për nga mosha dhe largësia e ardhjes. Në mesin e odës, në një sofër pishe, ishte ekspozuar botimi i librit nga edicioni i shtatë i këtij manifestimi.

Në muret e odës dukeshin për bukuri veglat e artit muzikor, çifteli, sharki, lahuta, të punuar nga dorë e palodhur e rapsodit të mirënjohur, Hysen Kurtaj. Në ballin e oxhakut, ende rrinte varur llamba e vajgurit, e cila vezullonte nga pastërtia, ndërsa reflektonte një pjesë të historisë sonë, kohën kur nuk kishim rrymë deri në vitet 60-ta të shekullit të kaluar.

Në mesin e dhomës, sipas traditës, kishin zënë vendin këngëtarë të njohur nga vendi, por edhe nga diaspora e largët. Sipas pikave të programit, me radhë kë-

donin këngë patriotike nga historia jonë e përvuajtshme, por krenare. Lahutari i njohur në rrafshin kombëtar, Hysen Kurtaj, ishte një atraksion i veçantë me këngë nga eposi jonë historik. Para fillimit të manifestimit sipas planifikimit nga artisti i skenës dhe letrari Ismet Krasniqi-Lala, në hyrje të dhomës u dëgjua thirrja tradicionale për të zotin e shtëpisë, "a doni miq orreeee!", ku pasoi përgjigja e z. Kurti, "O mirë se vini orreee!", ku veçohet mikëpritja e miqve me bujari nëpër shekuj.

Gjithë manifestimet nga trashëgimia jonë kulturore, vite me radhë, kanë të vetmin qëllim që më të rinjve t'ua kujtojmë kulturën tonë nëpër breza, vlerat thesariale që duhet të ruhen e kultivohen edhe në të ardhmen. Bazuar në tradita si pasuri e trashëguar ndër breza, njihemi, dallohemi nga popujt e tjerë të Evropës e botës. Si thesar dallues e trashëgimtar kemi pasur veshjen, mikpritjen, besën, bujarinë e shumë gjëra të tjera, që na kanë dalluar nga të tjerët. Në manifestimet e kaluara, është folur mjaft për simbolin më të vjetër shqiptar, për plisin, historinë dhe përdorimin, ndryshimet e pamjes në aspekte krahinore e tjera. Në kuadër të kësaj trashëgimie janë edhe veglat folklorike me të cilat nëpër shekuj i kemi kënduar jetës sonë në të gjitha aspektet, luftës e të paqes, gëzimit e hidhërimit, por edhe dashurisë.

Këtë radhë, letrari, poeti e kritiku me nam letrar, z. Prend Buzhala, trajtoi një temë interesante, "Kulti i nderit në raditën shqiptare", duke u thelluar në kodin e etikës dhe nderit tek shqiptarët, me temën, "Kulti i nderit në traditën shqiptare", duke elaboruar edhe disa pjesë kanonore. Si studiues që është, z. Buzhala zgjoi interesimin e të pranishmëve, duke trajtuar aspekte të filozofisë sonë në të kaluarën dhe të tashmen, si trashëgimi kanonore por edhe pasuri historike se si janë rregulluar normat e jetës brenda një kolektiviteti, gjithmonë me sundimtarë mbi kokë...

Në vazhden e traditave si trajtesë, zuri vend interesimi i veglës së folklorit tonë burimor shqiptar, lahutës, për të cilën foli lahutari Hysen Kurtaj, i cili pos tjerash shtoi: "Të dashur miq e vëllezër, me këtë lahutë kam kënduar kudo, në të gjitha trevat shqiptare, deri në Evropë e Amerikë. Kudo më kanë pyetur për këtë vegël të historisë sonë dhe u kam folur pa pritëse. Kur isha në disa vende të trojeve tona shqiptare, jam indinjuar shumë kur të rinj më pyesnin se "çka është kjo, si bie kjo... Më janë mbushur sytë me lotë, herë herë. Për këtë mosdije të brezave e paguam shtrenjtë, duke na e përvetësuar lahutën serbët si trashëgimi të tyre kombëtare. Këtë barrë historike le ta mbajnë kompetentët në udhëheqje shtetërore, institucionet arsimore, që nuk bëjnë sa duhet për ruajtjen e vlerave tona historike, përfundoi Hysen Kurti, duke ia thënë pastaj një kënge mjaft të prekshme për historinë tonë".

Në këtë manifestim kulturor të trashëgimisë sonë, si pikë programore ishte edhe leximi i poezive të poetëve nga trevat tona

dhe diaspora. Poezitë e tyre i lexuan:

Lulash Brigja, Rrahim Sadiku, Agim Desku, Idriz Berisha, Raif Gashi, Gjon Gjergjaj, Safet Hasani, Maxhun Osmanaj e të tjerë.

Kulminante e këtij manifestimi ishte momenti i ndarjes së disa mirënjohjeve nga ana e Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" nga Shkodra. Ndarja e mirënjohjeve u bë nga kryetari i kësaj shoqate, publicisti dhe aktivisti i dalluar i jetës kulturore, z. Ndue Sanaj. Kjo shoqatë është pjesë përbërëse e aktiviteteve të përbashkëta me intelektualët nga Klina, që disa vite. Mirënjohje iu ndanë për kontribute të veçanta në krijimtari dhe në jetën kulturore në tërësi:

Zymer U. Neziri e Frrok Kristaj iu dha titulli "Mirënjohje e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", ndërsa, Bajram Kelmendi, pas iu dha "Mirënjohja Mehmet Shpendi"; Sejdi Berisha, Tahir Bezhani e Gjon Gjergjaj iu dha "Mirënjohja Martin Camaj".

Të pranishmit e mirëpritën veprimin e z. Ndue Sanaj, duke i duartrokitur gjatë, ndërsa organizatori, Ismet Krasniqi -Lala e falënderoi përzemërsisht.

Në fund të këtij programi mjaft të bukur, pas falënderimit të organizatorit, në oborrin e kullës në Stankaj, vazhdoi programi me këngë të trashëgimisë popullore, këngë kapuçash, valle rugoviane, luajtur me një elegancë artistike të rrallë.

Një koktej me ushqime vendore, ishte mbyllja e kësaj dite të veçantë, mes krijuesve nga brenda e jashtë vendit, me vëllezër nga Shkodra e Presheva e vende tjera shqiptare, sikurse dhe nga diaspora. Ndarje e përqafime të përmallshme me shpresa për takime të serishme...

Sejdi Berisha



Një shkrim-reportazh që shënon një ngjarje, e cila tanimë është tradicionale, e që shënon rrugëtimin kulturor, për të forcuar themelet e pasurisë së vlerave shpirtërore dhe kulturore kombëtare, por është edhe mesazh që vë në dritë synimet që kultura kombëtare të bëhet sa më unike dhe të forcojë bashkimin e mendjes dhe të punës jo vetëm në fushën e kulturës dhe të historiografisë. Ky shkrim bëhet edhe më i qëndrueshëm dhe bindës e joshës edhe më shumë fotografi nga kjo ngjarje, pra, nga veprimtaria e VIII i "Dita e Plisit", që padyshim se ka peshë të veçantë për punën ambicioze të organizatorëve të këtij manifestimi, Ismet Krasniqi Lala, Prend Buzhala,, Idriz Berisha Xhixhi dhe Gjon Gjergjaj e shumë të tjerë që në mënyra të

ndryshme e mbështesin këtë ngjarje. Përshtendes në menyre të vecnte Kryesinë e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që më nderoj me kete titull kaq të lartë, me të madhin Martin Camaj, me albanologun Martin Camaj, me titullin "Mirënjohja Martin Camaj". Ju faleminderit dhe më keni nxite për më shumë punë në veprimtarine krijuese e botuese.

KULTI I NDERIT NË TRADITËN SHQIPTARE

(Trajtesë e lexuar në manifestimin DITA E PLISIT, edicioni VIII, në Stankaj – Rugovë, më 26 qershor 2021)

Prend Buzhala

Shkrimtar, poet, publicist dhe një nder organizatorët e veprimtarisë "Dita e Plisit të Bardhë"

Fizionominë e shpirtit të tij etnik e na-



cional, gjatë shekujve të pushtimit otoman e të atij sllav, populli ynë e cilësonte në bazë të vlerave që kishte krijuar nëpërmes Kanunit: besës e fjalës, burrnisë dhe nderit. Aty ngërthehen edhe vlera tjera siç janë mikpritja apo pleqnia. Mbështetje në rrëfimet gojore mbi bëmat dhe historinë, dhe, sidomos, në këngën proverbiale epike e kreshnike mbi trimërinë shqiptare. Ishte lahutari shqiptar, ajo figurë e spikatur etnike ndër shekuj e mileniume, që i mësonte përmendësh mijëra vargje dhe i këndonte bëmat epike, sepse, siç thuhet, ai këndonte *Kangën e Kombit*. Aty thadrohe lavdi i të parëve, i heronjve, i burrave pleqnarë e të urtë. Të gjitha këto vlera janë kultivuar në kullën shqiptare, e cila ishte vatër formimi, edukimi, kuvendimi, kënge, ekzistence e esence e qenies sonë. Kur flet për Fishtën e "Lahutën e Malcis", At Daniel Gjeçaj thotë: "Me këtë biná gurët e themelit apo elementet, që me ta përbajnë qoshet e kësaj kulle, fortesë ilire, janë: burri shqiptar, grueja shqiptare sokoleshë, besa shqiptare, ndera, mikpritja, urtia kanunore, mitologjia etj."

1. Rrezatimet semantike të nderit

Në kuadrin e këtyre cilësive, spikatet edhe një vlerë etiko-morale, tipike shqiptare, siç është kodi i nderit. Nëse, sipas Fjalorit tonë, nderi përkufizohet si "Tërësia e vetive a e tipareve morale të njeriut, që burojnë nga parime të caktuara, që çmohen nga shoqëria dhe që shfaqen në

sjelljet e në veprimet e tij në rrugë të drejtë; cipa e njeriut në shoqëri, që ai e ruan me krenari dhe që nuk lejon t'ia cenojnë": ky kod edhe sot nënkupton pastërtinë morale, "qëndrimin e sjelljen e virtytshme, ndershmërinë dhe besnikërinë (zakonisht për gratë)" (Fjalori), duke mbitheksuar, nga ana tjetër një etikë të marrëdhëniesve patriarkale.

Të gjitha kombet mburren me këtë kod, porse ndër shqiptarë ai merr një vlerë të veçantë jetike, ekzistenciale e esenciale, duke i identifikuar aty të vërtetën, sinqeritetin, dhe, mbi të gjitha, atë që mund të quhet e mira e përbashkët dhe më e madhja, që nga antika aristoteliane te vepër e tij "Etika e Nikomahut". E pra, është ai kod që lufton mashtrimin e vesin e keq dhe angazhohet për triumfin e vlerave etike-shoqërore.

Se Kodi i nderit është rrënjësor thellë në jetën shqiptare, i gurëzuar ndër shekuj; se këtij kodi ai i ka kushtuar rëndësi

mban gjallë a që ia siguron jetesën e lirinë, më vonë, në një shtet të lirë e të organizuar. Kështu, shqiptarin nuk mund ta përfityroje pa armën në brez apo në krah.

Kësisoj, sot do të mund të përktheje, si: askush mbi ligjin; apo siç do të thoshte Mahatma Gandhi: "Në çështjet e ndërgjegjes e të nderit, ligji i shumicës nuk vlen. "Madje, Kanuni e shqipton qartë këtë gjë:

"§.596. Nderen secili e ka për vedit e nuk mund t'i përzihet kush kush as me e rrethue me pë(n)gje e me pleq."

Nderi është personifikim për mikpritjen: "Shtëpia e Shqiptarit është e Zotit dhe e mikut".

Së këndejmi, nderi ishte edhe personifikim për atdhedashurinë. Që nderimet e nënshtrimit ishin të huaja për këtë kod etik, e dëshmon edhe thënia shqiptare: "Mos me i bâ kurr tungiatjeta anmikut". Me armikun nuk ke si të biesh në godi a marrëveshje. Nëpër këngët shqiptare të trimërisë, i dëgjojmë thirrjet e shokëve e të luftëtarëve, siç thuhet: "me i a kthye nderën Shqipnis." Jo më kot, te "Lahuta e Malcis", rënia dëshmor për Atdheun, personifikohej me lumturinë më të lartë e me nderimin më të lartë: *O ata t' lumt, qi dhanë jetën, / O ata t' lumt, qi shkrinë veten, / Qi për Mbret e vend të t' Parve, / Qi për erz e nderë t' Shqyptarve / Derdhen gjakun tuj luftue, / Porsi t' Parët u pa' n punue!*

Personifikimet e tilla zgjerohen gjithnjë e më shumë te këto vargje fishtiane: *Trima n' zâ, burra me nderë, / Larg t' permendun për urtë, / Larg te lypun për pleqni;*

2. Kodi i nderit te Kanuni i Lekë Dukagjinit

Në fakt, është përpjekje e secilit prej nesh veç e veç, po edhe e tërë shoqërisë, në përgjithësi, që përpiqemi për të qenë njerëz të shkëlqyer, të mirë, njerëz të ndershëm. Janë edhe dy aspekte që ndër lidhen me këtë kod: a) raportet në mes atyre që kanë dhe të të varfërve" dhe b) a duhet të jesh i ndershëm vetëm për shkak të frikës për t'u përmbajtur nga veprimet kriminale apo të dënueshme, apo do ta përqafosh ndershmërinë për shkak të ndërgjegjes së formuar si njeri? Gjatë shekujve njeriu ka shfaqur prirjet e tij lakmitare, dhe, sigurisht, që edhe librat e shenjtë, edhe kanunet a ligjet kushtetuese, ndër shekuj, formulojnë kërkesa të rrepta, për ta frenuar këtë lakmi me anë sanksionesh dhe për ta formuar njeriun si personalitet i lirë e i ndërgjegjshëm. Nëse te jo pak libra të shenjtë lexojmë vërtetë frikësuese (siç është bjerrja e parajsës apo e xhenetit); Kanuni e shikon praktikën etike në kuadër të ndërgjegjes shoqërore. Ja si e formulon te nja dy paragrafë: §.598. «Ndera e marrun nuk shpërblehet me gjá, por a me të derdhun të gjakut, a me të falun fisnikisht (përmbas ndermjesis së dashamirve të mirë). §.599. I korituni ka derën çilë për krahu ndera: peng s'shtron, pleq smërr, gjygy slypë; giobë s'mërr. Burri i fôrt mërr gioben vetë."

Kurse më tutje jepen edhe formulime në trajtën e ndonjë frazeologjizme a urtie etike: "Dy gisht nderë në lule të ballit na i njiti Zoti i Madh."

A duhet të shpërblehesh, po qe se tregohesh i ndërgjegjshëm e i ndershëm? A duhet të shpërblehesh veçan të tjerëve, po qe se ke luftuar për atdhe dhe ke ndihmuar të varfrit, bie fjala, si Nëna Terezë?

Etika e së kaluarës na thotë: ai që kërkon shpërblime të tilla, ai e shet nderin e tij. Janë guximi e mençuria që meritojnë mirënjohje e dekorime.

Ndërkaq, për etikën e fortë tradicionale shqiptare, humbja e nderit është e barabartë me vdekjen:

“§.600. Aj, të cillit i u muer ndera, xëhet i dekun kah kanëj a.”

Ndërkaq, te populli ynë ekziston edhe thënia: “Burri gjithçka fal për hatër të mikut e të dashamirit.

Në këtë aspekt, te Kanuni një tjetër kapitull formulohet si “Ndera shoqnore” e ku më shumë flitet për etikën e mikpritjes, mikut dhe bukës. Madje, në Kanun theksohet ky kult i nderit: se asht burri dhe nder, kush e pret dhe respekton mikun: “§.618. Mikut i lshohet kryet e vendit si për nderë, si edhe qi të jët mâ në të pâm e në shëj si edhe të mos të përzihet nder robët e shpis.”

Mbrojta e nderit përbën kapitull më vete te shoqëria tradicionale shqiptare, me formulime që qëndrojnë edhe sot, si: “§ 593. Kanuni i Maleve te Shqypnise, nuk e veçon njeriun prej njeriut. Shpirt për shpirt, se dukjen e fal Zoti”

Nëse në Kanun thuhet: “Për dy punë e ka fishekun në shpinë grueja e për një punë i pritët theku e lëshohet: a) për kurvni; b) për mik të prem.”

Ishte E Drejta Zakonore Shqiptare që e pajiste gruan me një fishek në pajë. Dhe nuk ka ndodhur që ky fishek të jetë përdorur. Sipas ritualit tradicional, burri, kur hynte në shtëpi, e çel derën e shtëpisë, me një trokitje, pastaj, në hapin e dytë me një goditje ndonjë kusie a gjëje tjetër në oborr, dhe së treti, pa hyrë brenda, duhej të kollitej. Nëse jarani i gruas nuk kishte ikur, atëherë i lihej e drejta t’i vriste të dy.

3. Thelbi i pastërtisë së nderit në etikën tradicionale shqiptare

Nga ana tjetër, pastërtia etike gjithnjë ndërli dhe me nderin e gruas më shumë se sa të burrit. Kështu krijohet përshtypja sikur Kanunet shqiptare e kanë keqtrajtuar gruan historikisht. Nëse në jo pak shoqëri tjera grua konsiderohej mall, objekt; ndër ne, siç na e thonë edhe këngët epike a baladat shqiptare, ngjashëm me Penelopën e Odisesë; femra shqiptare lartësohet; e ku femra i mbetet besnike burrit luftëtar, për të mos e prishur kurorën a besën e dhënë. Ishte traditë në shumicën e hapësirës shqiptare, që grua e martuar njëherë, po qe se do t’i ndodhte fatkeqësi burrit të saj në luftë a gjetiu, ajo të mos martohej më askund; kurse gjatë luftërave, siç dëshmohet, femra ishte e barabartë me mashkullin, duke e marrë edhe rolin e ushtrueses së detyrave të parit të familjes, meqë burrat e të rinjtë gjendeshin në luftë. Ndryshe, grua është personifikim i Kodit të nderit shqiptar.

Studiuesi e albanologu gjerman George Hanns, shkruan se bareshat shqiptare, Nën sundimin otoman, janë të lira e nderi i gruas së krishterë nuk preket, e po qe se preket, atëherë keqbërësi ndëshkohej, siç dëshmon edhe Bajroni: kush e prek atë, e paguan me kokë. Ky poet diku tjetër poetizon: “Femra shqiptare vetëm njërit ia fal trupin dhe zemrën.”

Nuk janë të rastit edhe emërtimet kategorizuese shoqërore-familjare, si: zot i shtëpisë, dhe zojë shtëpie.

Por, siç dëshmon Çajupi, në Shqipëri



janë gratë që punojnë. Gratë udhëtojnë të sigurt. Nëse një grua ka një fëmijë të paligjshëm, nëna ka nderin e humbur e fëmija quhet kopil. Ishte kështu, sepse ndryshe nuk kishte si të frenohet prostitucioni.

Nga ana tjetër, Kulti i familjes e i solidarësisë brenda familjes, te shqiptarët është shumë i fortë.

Çka do të thotë cenimi i nderit?

Të mos harrohet: në të kaluarën (në mungesë të institucioneve, ligjeve dhe shtetit), kur një trimi shqiptar ia kanë sulmuar identitetin e tij, Skënderbeun, flamurin apo historinë), ka ndodhur, si në rregullat e kanunit... d.m.th. ta ketë nxjerrë shpatën ose armën dhe e ka goditur sfiduesin! Mu si në fushën e mejdanit, si ndodh tek Gjergj Elez Alia. E këta bajlozë kanë qenë pushtues, qeveritarë të huaj, të ardhur nga Lindja apo nga Perëndimi. Edhe hyzmeqarë vendas, nga politika a shtresat shoqërore. Bajlozët pushtojnë tokat e kreshnikëve, imponojnë rregullat, haraçin e mizori tjera, si: *M’ke lypë motrën para se mejdanin, / m’ke lypë berret para se çobanin, / e jam dredhë n’ket log për me të kallzue, / se ne t’parët një kanu na kanë lanë / armët me dhanë përpara e mandej gjanë, / kurr bajlozët motrën me ia dhanë / përpa u pre nat fushën e mejdanit.*

Gjergji, me nëntë plagë në trup, vret bajlozin.

Por, fatkeqësisht, sot, lejohen njollosje masive edhe të nderit kombëtar. Por PSE ndodh kështu me njollosjen e poshtërimin e së kaluarës sonë nga albanofobë të brendshëm e të jashtëm?

Studiuesi Lutfi Alia, në punimet e tij kushtuar Kanunit, thekson: “Nderi përbën një ndër institutet kulmore të Kanunit të Leka Dukagjinit dhe si koncept ka funksion të dyfishtë: nga një anë është normë morale fundamentale, që përfaqëson kultin e nderit, në të cilin mbështetet shoqëria shqiptare dhe nga ana tjetër, shpreh kodin e nderit, me ligje e norma etiko- morale, të detyrueshme të respektohen nga individët dhe nga komunitetet (nderi i familjes, nderi i fisit, nderi i fshatit, i krahinës dhe i atdheut) (Libri 8°, kreu 17° dhe kreu 18°).”

Nderi dhe burrëria karakterizojnë figurën e shqiptarit.

4. Në përfundim

Është e natyrshme, që, ashtu sikundër vetë shoqëria që pëson ndryshme, këso ndryshimesh të pësojë edhe vetë kjo kategori tradicionale, siç është kodi i nderit. Le t’i kemi si dëshmi fejesat dje e sot, apo martesat dje e sot: kur dje ishte e dënueshme dashuria mes dy të rinjsh, dhe ata duhej të fejojeshin me shkuesi.

Te këngët epike kreshnikët e luftëtarët jepen në kërkim të lavdisë dhe ta shtojnë nderin, kurse Kanuni kudo e lartëson në kult këtë kod etik, me norma, qëndrime e mënyra të sjelljes, ashtu sikundër që ka edhe norma se si mbrohet nderi, sidomos nderi vetjak. Edhe vetë shoqëria moderne sot, me anë ligjesh garanton dhe mbron nderin e dinjitetin e njeriut.

Ndue Sanaj e Lulash Brigja

Presheva, Medvegja e Bujanoci pikë neuralgjike dhe çështje e pazgjidhur kombëtare shqiptare

Prof. Rexhep Abazi*

Komuna e Medvegjës shtrihet në jugun e Serbisë, në pjesën më të pazhvilluar të saj, jo se nuk ka mundësi dhe kushte, por qëllimisht për shkak të popullatës shqiptare që jeton në te, apo në Kosovën Lindore, siç e quajmë ne shqiptarët. Gjendet në kilometrin e gjashtëdhjetë të rrugës Prishtinë-Leskoc, 180 km. nga Presheva e 150 km. nga Bujanoci. Ka një territor kodrinor e malor, me male të bujshme të ahut, bungut, shkozës dhe pak pisha të mbjella vende-vende. Ka tokë të mirë pjellore e cila lejon kultivimin e grurit, misrit, elbit, thekrës, tërshërës, patates, pemëve dhe parimeve. Ka xeheroren e Lecit, në të cilën dikur me sukses nxirrej ari e plumbi, kurse sot punon me kapacitete të zvogëluara e me numër të vogël të punëtoreve, sa për mirëmbajtje për t' mos u mbyllur. Dikur kjo xeherore ishte në përbërjen e kompleksit gjigant xeherore-industrial "Trepça", kohë kjo kurë lulëzonte prodhimi dhe zhvillimi i sajë. Ka edhe Bajën e Siarinës, një gjerdan të trojeve shqiptare, me një numër të madh burimesh natyrore të ujërave minerale me veti shëruese, për pirje, për larje dhe masazh, ndoshta sipas vetive shëruese e para në Evropë, por tërësisht e pa ndërtuar dhe e pa zhvilluar. Popullatën e Medvegjës e përbëjnë shqiptarët autokton dhe serbët e malazezët kolonistë të ardhur në tokat shqiptare pas vitit 1878.

Çfarë ndodhi në vitet 1877/78?!

Perandoria Osmane në vitin 1878 i braktisi apo i shiti tokat shqiptare të sanxhakut të Nishit, të Leskocit, Prokupjes, Kurshumlisë, Vrajës e të tjera, duke u tërhequr me ushtrinë e saj nga këto toka. Shqiptarët mbetën të pa mbrojtur dhe të pa armatosur për vetëmbrojtje. Serbia i sulmoi vendbanimet shqiptare me ushtri e banda paramilitare dhe kriminelësh duke i vrarë me burra e gra dhe me fëmijë të gjithë ata që nuk i lëshonin trojet e veta. Ishte situatë tmerruese dhe alarmante kur njerëzit në dimrin e ftohët u detyruan të braktisnin shtëpitë dhe trojet e veta për të shpëtuar kokën. Një pjesë e kësaj popullatë që mbeti në tokat e veta, e që me siguri nuk ka qenë edhe aq e vogël, me kohë e nën tryshninë e madhe është asimiluar dhe për këta kurrë kush nuk e tha as një fjalë të vetme.

Shtëpitë e shqiptarëve plaçkiteshin e pastaj digjeshin për të pamundësuar kthimin eventual të tyre.

Ishte tmerruese situata e muhaxhirëve të cilët në acarim e paparë e në borën e madhe të dimrit të viteve 1977/78 lëviznin në drejtim të Kosovës. Tregohet se njerëzit vdisnin nga të ftohtit dhe uria, rrugës mbetnin të ngrirë dhe pa u varrosur.. Kishte raste kur nënave u shpëtonin fëmija nga krahu dhe ngrinin e vdisnin në borën e akullit.

Kështu, sipas studiuesit Dr. Sabit Ukës,

në këtë kohë u zbrazën afro 740 vendbanime shqiptare dhe në të njëjtat u sollën kolonistët serb e malazez, pasardhësit e të cilëve edhe sot jetojnë në këto troje.

Edhe komuna e Medvegjës e pagoi çmimin e kësaj kohe, duke u zbratur nga shqiptarët afro tridhjetë e dy (32) dy vendbanime e duke u kolonizuar nga kolonistët serb e malazez.

Për çudi, në këtë komunë në at kohë mbetën dymbëdhjetë (12) vendbanime me shqiptarë, të cilat janë edhe tani me një numër të reduktuar të banorëve shqiptarë.

Kufiri i ri në mes Perandorisë Osmane dhe Serbisë u vu në vendin e kufirit të sotëm që e ndanë Kosovën me Serbinë. Prandaj fshatrat shqiptare të Medvegjës mbetën nën ingerencat e Serbisë.

Në të njëjtën kohë, Bujanoci e Pre-



sheva mbetën nën Perandorinë Osmane, duke e vu kufirin në vendbanimin Ristoc, afër Bujanocit.

Kjo situatë zgjati deri në vitin 1912 kur Serbia e pushtoi Kosovën dhe arriti deri në kufirin me Shqipërinë.

Pas përfundimit të luftës së dytë botërore Serbia aneksoi Preshevën e Bujanocin dhe kështu kjo mbeti deri në ditët e sotme. Tani Presheva, Bujanoci e Medvegja mbesin edhe më tutje nën Serbi, nën tryshninë e paparë të padrejtësive dhe vuajtjeve që i përjetojnë për çdo ditë.

Sakrificat kombëtare për liri e pavarësi

Këto tri komuna shqiptare edhe pse të mbetura nën Serbi, asnjë herë dhe në asnjë kohë nuk e pranuan vendin si të shkëputura nga trojet e tjera shqiptare dhe nga trangu kombëtar, por vuajtjet i përjetuan dhe po i përjetojnë nga shteti i Serbisë.. Edhe pse në kushte shumë të vështira shqiptarët e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit, u munduan të japin kontributin e tyre në ngjarjet e rëndësishme historike të

kombit shqiptar.

Medvegja ekzistoi e veçoi në rrethana dhe kushte specifike, pasi që shqiptarëve iu hoq e drejta në qeverisjen lokale që nga viti 1956, kur u shua Komuna e Bajës së Siarinës të cilën e qeverisnin shqiptarët dhe ishin shumicë. Rajoni i kësaj komune iu bashkëngjiti Medvegjës, ku shqiptarët mbetën pakicë dhe kështu kurrë më nuk patën mundësi të vendosin për fatin e vet dhe të trojeve të tyre.

Kryetari i fundit shqiptar i Bajës së Siarinës ishte tani më i ndjeri z. Rahim (Hysen) Abazi, ose siç e quanin Rahimi i Hysenit, nga Sfirca, me nënkryetarin Zeqir (Fejzë) Zeqirin, quajtur edhe Zeqa i Fezës, nga Tupalla. Tani, që nga kjo kohë shqiptarët i zgjidhnin përfaqësuesit e tyre në kuvendin komunal, por kurrë nuk kishin mundësi të ndikonin në

t'i ikur burgut dhe maltretimeve e shantazheve të tjera që i bënte shteti ndaj tyre. Si pasojë e kësaj edhe sot e kësaj dite ata nuk u kthyen më në vendlindjet e tyre por jetojnë e veprojnë në mërgim. Kjo ishte vala e dytë e zbrazjes së trojeve shqiptare të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit.

Përkundër kësaj të rinjtë e këtyre komunave dhe intelektualët gjithmonë morën pjesë në çdo ngjarje me karakter kombëtar që zhvillohej në trojet shqiptare, duke e paguar veprimin e tyre me çmime të larta, qe besa disa edhe me jetën e tyre, si në demonstratat studentore po ashtu edhe në të gjitha përpjekjet dhe luftërat që bënë shqiptarët për liri e pavarësi.

Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore nuk u solli asnjë të mirë këtyre trojeve etnike shqiptare. Luftërat Ballkanike po kështu. Ngjarjet e historisë më të re të kombit shqiptar e sidomos prej vitit 1981 e këndej situatën në këto tri komuna e përshkallëzuan me shtimin e presionit ndaj shqiptarëve, sidomos ndaj rinisë dhe ndaj intelektualëve.

Me ardhjen e Sllobodan Millosheviçit në krye të Serbisë, situata arriti shkallën më të lartë të presionit. Mbase, edhe shqiptarët nuk ndejnë duarkryq, por vepronin aq sa kishin mundësi. Me 1 dhe 2 mars të vitit 1992 organizuan Referendumin për Bashkëngjitje me Kosovën, me rezultate të larta gati se njëqind për qind pro, gjë që e irritoi edhe më shumë shtetin e Serbisë. U rrahën deri në alivanosje shumë të rinj, organizatorë të referendumit, u konfiskuan materiale, besa disa edhe u burgosën.

Situata dita me ditë përshkallëzohej e përkeqësohej deri sa shpërtheu lufta çlirimtare në Kosovë, kur i tërë populli shqiptar e pranoi këtë luftë si luftë të veten çlirimtare. Në radhët e UÇK-s u radhitën edhe të rinjtë e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit. Nga Medvegja, gjegjësisht nga fshati Kapit, në luftën UÇK-s, në altarin e lirisë ra heroji Florim Rushiti-Kingji. Luftëtari i UÇK-s nga Sfirca e Medvegjës, gjeneral Zymer Halimi, sot punon si oficer i lartë i Ushtrisë së Kosovës, me shtatë plagë në trup të marra në luftën çlirimtare të Kosovës.

Kuptohet se Presheva e Bujanoci dhanë numër më të madh të pjesëmarrësve në këto ngjarje, konform numrit të popullatës.

Pas çlirimit të Kosovës, në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc u formua Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit, e cila zhvilloi luftë të suksesshme kundër regjimit të atëhershëm të Serbisë, ranë 29 (njëzet e nëntë) dëshmorë, por fatkeqësisht shqiptarët e kësaj toke përsëri mbetën me vuajtjet e vjetra, sepse Serbia nuk u demokratizua e nuk respekton të drejtat e shqiptarëve.

Lapidarin e dëshmorëve të UÇPMB-s, të ngritur në oborrin

Çrregullimet antisociale të personalitetit



Personi me çrregullime antisociale të personalitetit, mendohet shoqërisht i rrezikshëm. Është shumë eksploziv, mjafton një ngacmim i vogël dhe ai shpërthen. Mendohet tipi "minë me sahat".

Çrregullimet antisociale të personalitetit, shfaqen që në fëmijërinë e hareshme, dhe në moshën rinore.

Ato, janë shumë të ngjashme me psikopatinë. Në të dyja rastet, personi nuk ndien fajësi dhe as përgjegjësi për dëmet që u shkakton të tjerëve.

Studiot psikologjike kanë arritur në përfundimin se, në çdo nocion, tre për qind e burrave dhe një për qind e grave, vuajnë nga çrregullimet antisociale të personalitetit. Ky numër varet shumë nga kultura social juridikë e nocionit. Në vendet me kulturë social juridikë të ultë, numri është shumë më i lartë.

Vendgrumbullimi i tyre, janë burgjet. Tek të burgosurit e dënuar për dhunë, numri arrin deri në pesëdhjetë për qind.

Diagnostikimi, edhe për ekspertët, është i vështirë. Kjo për faktin se i sëmuri ka aftësi të madhe për fshehjen e shenjave të sëmundjes. Në momentet që i duhen, i sëmuri sillet i arsyeshëm dhe tregon bashke ndjenja për të tjerët. Po kaq i vështirë është edhe mjekimi. I sëmuri e

mendon veten në rregull dhe nuk e ndien nevojën e mjekimit. Në të shumtën e rasteve e refuzojnë çdo lloj mjekimi dhe ndihme.

Megjithatë simptomat, që tregojnë për një të sëmur të ardhshëm, janë të qarta, për çdo rast.

Një fëmijë që vjedh, është agresiv, gënjen, tregohet kokëfortë përballë prindërve dhe mësuesve, dhunon të tjerët, braktisë shkollën, është shumë i rrezikuar nga sëmundja.

Një i rritur, që të mendohet i sëmur nga çrregullimet antisociale të personalitetit duhet, minimumi, të shfaq këto simptoma:

1. Sjellje brutale, pa ndjenja, me të tjerët.
2. Injorim i normave, rregullave dhe detyrimeve sociale.
3. Vendosja dhe prishja e shpejtë e lidhjeve me të tjerët.
4. Mungesë tolerance dhe agresivitet, deri në përdorim dhune.
5. Mungesa e ndjenjës së fajësisë, për çdo rast dhe ndaj cilitdo.
6. Injorimi i masave të mundshme ndëshkuese.
7. Tendencë për të fajësuar të tjerët për veprimet dhe pasojat e tyre antisociale.

Psikologët mendojnë se, çrregullimet antisociale të personalitetit, janë rrjedhojë e trashëgimisë gjenetike dhe e mjedisit. Sa njëra dhe tjetra. Një studio gjenetike daneze, ka arritur në një përfundim interesant: 70 për qind e të dënuarave përsëritës për krime ndaj pronës dhe, 50 për qind e atyre për krime kundër personit, janë „viktima“ të trashëgimisë gjenetike.

Në Amerikë, babë e bir, pas disa vitesh ndarje, u bashkuan përsëri por, në një vend aspak të këndshëm-në burg. Të dy ishin dënuar me vdekje për krimin e vrasjes. Por, kishin dhe një pasion të përbashkët-

lojën e shahut. Gjatë kohës në burg, ata luanin shah me njeri tjetrin. Për arsye të dënimit me vdekje, nuk mund të ishin në një dhomë bashkë. Lëvizjet e gurëve të shahut, u tregonin rojet e burgut.

Psikologët janë të mendimit se, në rastin konkret, çrregullimet antisociale të personalitetit, janë trashëgimi gjenetike.

Tek binjakët njerëzore, në të shumtën e rasteve, sëmundja shfaqet tek të dy, në të njëjtën masë dhe intensitet.

Fakti që ajo fillon që në fëmijëri e hareshme, do të thotë se prindit, me sjelljet e tyre, kanë një influencë të madhe tek pasardhësit e tyre.

Të sëmuret, në shumë raste, kanë kaluar një fëmijëri të dhunshme. Ata e kanë përjetuar dhunën dhe nuk ndiejnë dhembje apo keqardhje kur i dhunojnë të tjerët. Është i njohur principi psikologjik: Kush dhunohet, do të dhunojë

Shumë prindër sillen para fëmijëve të tyre në mënyrë antisociale. Kaq ishte, u krye e liga.

Në një rast po bisedoja me babain e një djali, i cili ishte dënuar për vrasje. Djali, në moshën 12 vjeç, ishte futur në rrugën e kriminalitetit. Në moshën 17 vjeç kishte kryer një vrasje dhe vazhdonte të vuante dënimin. Edhe në burg, ai karakterizohet nga mosbindja, injorimi i rregullave dhe dhuna permanente mbi të tjerët. Burri përballë, ma ndërpreu menjëherë fjalën: "PO, veç e ka baba trim", tha ai, duke qeshur vesh më vesh. Atij tipi primitiv, i duhej një trim në shtëpi, sipas mendje së vet dhe jo djali.

Nëse prindit nuk i falënderojnë fëmijët për sjelljet e mira por, në vend të kësaj i ndëshkojnë vazhdimisht për gabimet e tyre, tek fëmijët zhvillohet ndjenja e të sjellurit antisocial.

Fëmijët mësojnë se, që të përfitosh vëmendjen e prindërve duhet të sillesh keq.

Dhe për të tërhequr sa më shumë vëmendjen e prindërve, bëjnë sa më shumë ligësi.

Shumë prindër, as nuk merren fare, me edukimin e fëmijëve të tyre, me vlerat morale, rregullat dhe normat sociale. Fëmijët nuk mësojnë nga prindit e tyre, të rëndësishmen dhe të parëndësishmen, e imja dhe e jotja.

Në fazën e pubertetit, disa fillojnë karrierën e krimit. Vjedhin, rebelojnë, dhunojnë dhe kryejnë veprime antiligjore, nga më të ndryshmet.

Fëmijët e pabindur dhe të gatshëm për të luajtur me rrezikun, që nuk tregojnë ndjenja dhe respekt për të tjerët dhe mjedisin, janë shumë të predispozuar për infektim nga sëmundja. Edhe inteligjenca e reduktuar luan rol të rëndësishëm në prekjen nga sëmundja.

Psikologët paralajmërojnë se, mjekimi i të sëmurëve me çrregullime antisociale të personalitetit, nuk është i lehtë. Medikamentet dhe psikoterapi, në shumë raste, nuk japin rezultat.

Aq kohë sa pacienti nuk e kupton se, qëndrimet dhe sjelljet e tij ndaj të tjerëve, dhe mjedisit janë të kundraligjeshme dhe të rrezikshme, çdo terapi është e dështuar. Veçanërisht kjo, për moshat e rritura.

Pacienti në moshë të rritur, është plotësisht i bindur se, një sjellje normale me të tjerët dhe mjedisin, nuk e përmirëson aspak kualitetin e jetës së tij. Ai ndihet shumë mirë, ashtu siç është, në nën-lëkurën e vet.

Është fatkeqësi e madhe social dhe kombëtare, nëse, tipa të tillë, bëhen të pushtetshëm. Dhe ndodhë, jo rrallë.

LEKË IMERAJ - shkrimtar, përkthyes, publicist

◀ e komunës së Preshevës, shteti i Serbisë me forcat e armatosur deri në dhëmb, e shkuli nga oborri i Komunës së Preshevës dhe sot e kësaj dite nuk dihet se çfarë ka ndodhur me te.

Nxënësvë dhe studentëve shqiptarë të cilët shkollohen dhe mbarojnë studime në republikën e Kosovës, nuk u njihen diplomat dhe dokumentet e tjera shkollore, andaj as nuk mund të themelojnë marrëdhënie pune.

Deri në vitin shkollor 2020/21 nxënëseve të shkollave shqipe nuk u lejohej përdorimi i teksteve shkollore nga Kosova e nga Shqipëria, kështu që ata ishin të detyruar të mësonin nga librat e viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, të përkthyer nga gjuha serbe nga njerëzit jo kompetent e joprofesional, me gabime gjuhësore, teknike e materiale.

Në shkollat shqipe nuk shpallen konkurse për plotësimin e vendeve të punës me quadro profesionale mbi njëzet vite. Një numër i madh i punëtorëve në shkollat shqipe punojnë pa kualifikime të duhura dhe me kontrata pune në kohë të caktuar. Në shkollën fillore "Zenel Hajdini" në Tupallë, nuk zgjidhet drejtori i shkollës në mënyrë të rregullt dhe me konkurs, por kjo shkollë mbahet me Ush-

trues të detyrës së drejtori gati qe njëzet vjet.

Në ambulancat dhe shtëpitë e shëndetit në Medvegje nuk punon asnjë mjek as infermier shqiptar, jo që nuk ka, por nuk pranohen në këto punë shqiptarët.

Administrata mbahet vetëm në gjuhën serbe, me alfabet të çirilicës, kështu që shumë emra e mbiemra shqiptar deformohen në të shkruar. Fatkeqësisht, në Medvegje tek shumë shqiptarë tek mbiemri është i shtuar sufiksi -viç, si fazë e parë e asimilimit, edhe pse kjo dukuri ka qenë dashtë të zhdukej që nga viti 1972, sipas vendimeve të organeve kompetente vendore e qendrore. Në kohën e fundit, shteti i Serbisë po bën spastrim etnik të shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit me të ashtuquajturin PASIVIZIM TË ADRESAVE të banorëve shqiptarë refugjatë apo të zhvendosur gjatë luftërave të viteve 1999/2000, nën presionin e forcave ushtarake, militare e paramilitare të asaj kohe, por jo vetëm të tyre, edhe të banorëve rezidentë, duke i shpallur adresat e vendbanimit të përhershëm pasive, me ç' rast njerëzit e humbin të drejtën e banorit rezident, të drejtën e votës, të drejtën në dokumente të identifikimit dhe të udhëtimit, të drejtën në regjistrimin au-

tomjetit, të drejtën në shitblerje dhe bartje të pasurisë së patundshme dhe shumë të drejta të tjera individuale të garantuara me ligjet e këtij shteti dhe me konventat ndërkombëtare.

Vetëm në komunën e Medvegjës ky numër e kalon shifrën prej 5000 personave, gjë që për Medvegjen është katastrofike dhe alarmante. Kjo është faza e tretë dhe më fatale e spastrimit etnik të shqiptarëve në Serbi.

Unë mendoj se këto sakrifica që po i bën popullata shqiptare në Serbi, dhe që i ka bërë në vazhdimësi, sidomos me qëndrimin e tyre stoik në trojet stërgjyshore, janë më tepër se sakrifica, janë vuajtje e luftë e fanatizëm për t'i ruajtur këto troje shqiptare.

Mirëpo, po frikohem se në se faktori kombëtar shqiptar, si edhe faktorët ndërkombëtarë nuk e kuptojnë këtë situatë më se kritike dhe nuk ndërmarrin hapa dhe masa të duhura, do të bëhet edhe ky rajon një Toplicë, apo Çamëri e dytë.

Lus Zotin, përgjëroj faktorin kombëtar, tani më me dy shtete shqiptare (Shqipëri-në dhe Kosovën), faktorin ndërkombëtar i cili ka bërë shumë për shqiptarët, që edhe kësaj here të vihet në mbrojtjen e shqiptarëve të vuajtur e të stërvuajtur në Pre-

shevë, Medvegje e Bujanoc.

Kuptohet, që faktori shqiptar në Preshevë, Medvegje e Bujanoc, nuk ka as mundësi imagjinare që këto probleme t'i zgjidh vet, gjë që e verifikoi edhe koha që nga vitet e eksodit shqiptar të trojeve të Sanxhakut të Nishit, Prokupjes, Leskocit, Vranjës e të tjerë, që prej viteve 1878 e deri në ditët e sotme, përkundër përpjekjeve e sakrificave më sublime në vazhdimësi.

Lavdi dëshmorëve dhe veprimtarëve të rënë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha luftërat për liri e pavarësi!

Rroftë kombi shqiptar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si aleati më besnik i tij!

(Ekspoze i paraqitur ne Tryezen shken-core, te organizuar nga Shoqata Vellazerore Koove-Mlesi e Madhe "Martin Dreshaj", me qender ne Peje, i majtur ne "Rugova-camp", ne Rugove, me 12 qershor 2021).

*Medvegje, adresa:

16246 Bajë e Stari nës, Rr. K. Milan 12, e-mail: rexhepabazi8@gmail.com, telefon 00381637147251

GJITHÇKA DUHET TË DIHET PËR ETIKEN MJEKËSORE

Për etikën është e vështirë të jepet një përkufizim i saktë ose të përcaktohen vlera dhe rregulla (principe), që përcaktojnë qëndrimin e mjekut. Shoqëria u kërkon mjekëve të ndjekin një “moral”. Sot është i keqinterpretuar, nga që kujton shënimet filozofike dhe i referohet një faji individual. Po ashtu shprehja “moral mjekësor” shpesh është zëvendësuar me “etikë mjekësore”. Në fakt etika vjen nga fjala greke “ethos”, që do të thotë “zakon” dhe nga fjala “moralis” në latinisht që do të thotë “zakon – moral”, të cilat janë sinonime.

Etika mjekësore – sot vlerësohet si sjellje private dhe publike e njeriut të çdo profesioni, që gjykohet në raportin e sjelljes së tij krahasuar midis të mirës dhe të keqes në favor të principeve të mira. Nocioni etikë mjekësore sot nuk raporton përgjegjësinë personale të secilit person, në praktikën mjekësore. Për kohët e fundit përdorimi etikë mjekësore kufizohet në rregulla kolektive (gjë që e afron me Deontologjinë) ose në rregulla që përdoren në kërkimet mjekësore (që e afron) me Bio – etikën.

Si përkufizim etika mjekësore dikton rregulla, sjellje të mjekut, kur në praktikën e tij bën thirrje pacientit që ballafaqohet me zgjedhje mjekësore dhe sidomos kur paraqiten rrjedhoja që është e vështirë për ti vlerësuar. Qëllimi i mjekut, do duhet të diktohet nga sjellja e tij morale që mbetet e njëjtë: - të bëjë mirë sa të jetë e mundur me çdo mjet, dhe në të njëjtën kohë “të mos bëjë keq” sipas shprehjes Latine “Primum non nocere”, “në radhë të parë mos dëmto”. Në pamje të parë gjithçka duket e thjeshtë, por paraqitja të gënjen, të mashtron. Nga që çështja shtrohet të dihet çfarë kriteresh janë të lejuara në shoqëri për të garantuar se bëhet mirë. Teoritë që disponohen për ti dhënë përgjigje kësaj pyetje: Disa i referohen një ideali shumë më të lartë, të tjerët i drejtohen një identiteti të përkryer, një hyji transcendent (një mendje hyjnore) burim i rregullave të sjelljes njerëzore dhe një grup, tjetër vlerësojnë në mënyrë pragmatiste, duke u nisur nga rezultatet.

Për mjekun, nuk bëhet fjalë të përdoren teori, por ti jepet përgjigje kësaj çështje rast pas rastit dhe konkretisht

duke marr konsentin (pëlqimin) e pacientit për çfarëdo procedure të përdorur. Për ata ka rëndësi të zgjidhet e keqja më e vogël, do të thotë të pakësohet dhimbja, vuajtja, kjo nuk do të thotë aspak se mjeku nuk ka asnjë bindje morale ose nuk kërkon të prak-

personale, gjë që çon dhe në kategorizimin e të sëmurëve duke i izoluar ato (si në kuti) e duke i konsideruar ato si objekt dhe jo si subjekt (person) që vuan. Në anën tjetër shkenca funksionon pa ndërprerë me mjete të reja diagnostike dhe terapeutike.



tikojë një model. Sidoqoftë veprimtarit kërkimore dhe klinike do ti nënshtrohen një shumice kriteresh praktike, që janë ligje dhe aplikime profesionale të kolegeve bashkëpunues dhe të palëve ndërvepruese. Mjeku, po ashtu është i detyruar të bëjë llogaritë e zgjedhjeve të veta në funksion të eksperiencës personale shkencore duke përpunuar strategji për të zvogëluar vuajtjet.

Etika dhe ligji

Mjeku u bindet ligjeve ose rregullave që vendos shoqëria ku jeton. Pra, si aplikon ligjet etikë mjekësore në sensin juridik të temës: kodi i shëndetit publik, dekretet ministeriale, rekomandimet protokollare e të tjera. duke u mbrojtur kështu nga rreziqet në proces. Ligjet, megjithatë nuk është e lehtë për ti përdorur (aplikuar) dhe mund të ketë vend për konflikt në koshjencën dhe eksperiencën e mjekut. Për natyrën e vet normative nganjëherë frenohet çdo iniciativë

Sot janë krijuar situata të pa imagjinuara më parë, por ama po veprohet për ditë në botën moderne si: trapiantet (transplantimet e organeve), vendosja e protezave valvulare artificiale, protezave të gjurit, koxo – femorale, Bypass koronare, angioplastike me vendosje të stenteve e të tjera, kontrolli i riprodhimit ose manipulimet sipas hartës gjenetike të njeriut (gjenomës humane). Për këtë duhet që rregullat dhe ligjet të ripërtërihen dhe të jenë koherente, të mos vjetrohen, sepse mjeku ka detyrë të bëjë më të mirën për pacientin, ta bëjë cilësisht mirë dhe brenda këtij kuadri të mos gjendët jashtë ligjit.

Kur propozohet përdorimi i qëndrimeve të reja në shumë raste ajo mbështetet nga komisionet e etikës ose komitetet konsultative për të mbrojtur personat për kërkimet bio – mjekësore (komisioni bio – etikë).

Përball një rasti konkret mjeku

ngrenë çështjen nëse për këtë person duhet t'i referohemi principeve të përgjithshme që lënë hapësirë veprimi apo të ndiqen dekretet e ligjet e shkruara. Në fakt teksti nuk mund të qeveris etikën e mjekut, nga që ato janë të ngurtë, shpesh të vështirë të shqyrtohen, të kufizuar dhe lënë vend për hipokrizi mjeko – ligjore.

Një shembull i vështirësive është marrja e konsentit (pëlqimit) të pacientit nëse donë të mbrohet nga rreziku i procedimit (gjykimit) e i dënimit. Pra, për këtë ai (mjeku) duhet të informojë pacientin (të sëmurin) me shkrim ose në prani të familjareve ose personave të tretë (si dëshmitar), kështu një urografi intravenoze me “Lipjodol” për veshka mund të paraqes një rrezik vdekje – prurës (qoftë dhe minimal) nga reaksioni alergjik ndaj jodit, që ka kontrasti për të paraqitur imazhin radiologjik të aparatit urinar. Mirëpo qëllimi etik nuk është të rrisë ankthin e pacientit, por të vendosi një marrëdhënie besimi, të dëgjoj dhe të kuptojë dhe të shpjegoje nevojën e këtij ekzaminimi dhe të vlerësojë shqetësimet e tij dhe të mos i shkaktojë atij frikë për eventualitetin e një ndodhie si përjashtim. Në këtë rast mund të merret një vendim për ta shtruar 2–3 ditë të sëmurin sa të qetësohet pas bërjes së kësaj urografie.

Efikasiteti i marrjes nën kujdes dhe trajtimi adekuat është më mirë, kur pacienti është i bindur për vendimin që merret, se ligjet nuk ndryshojnë asgjë.

Etiket dhe parat

Zgjedhjet ekonomike ndërhyjnë në ndërgjegjen e mjekut dhe të personelit të shëndetësisë. Në sferën ekonomike etika mjekësore e bazuar mbi vendimet personale u kundërvihet vendimeve kolektive. Ajo është në veçanti e përballur me zgjedhje politike, të mjeteve ekonomike, të shëndetësisë për t'iu atribuuar buxhetit, për të ndërhyrë; në politikën shëndetësore të përditshme.

Në se është e logjikshme, që mjeku të inkurajohet të bëjë llogaritë e shpenzimeve të trajtimit dhe të ekzaminimeve suplementare, që përshkruan, duhet në çdo rast të bëhen llogaritë ekonomike për kujdesin ndaj pacientit ose ndaj grupit të pacientëve duke

marr parasysh rreziqet e këtyre të fundit, që mund të çojnë në kufizimin e shanseve për shërimin e tyre.

Disa zgjidhje janë të dhimbshme, kështu për arsye buxheti disa trajtime shumë të shtrenjta nuk mund të realizohen nga çdo pacient. Kështu është vendosur nga komisione mjekësh në emër të shoqërisë të cilët do të jenë ata të sëmur, që do përfitojnë si: “më të rinjtë”, ato që nuk kanë sëmundje të renda shoqëruese, pra mjekët llogarisin moshën, gjendjen shëndetësore dhe prognozën e sëmundjes. Kjo është e domosdoshme për një farë kohe pak a shumë të gjatë, për gjithë terapitë e reja, të cilat nuk mund të përhapen menjëherë në çdo vend. Kjo është dramatike dhe e vështirë të kuptohet dhe të pranohet nga shoqëria si p.sh: një i moshuar nuk përfiton kujdesin më të mirë të mundshëm nga që kjo metodë ka kosto të shtrenjtë për shoqërinë, por kjo do të ndodh shpesh për arsye të propozimeve gjithnjë në vazhdim të mjeteve të reja terapeutike që kushtojnë shtrenjtë dhe nuk përballohen.

Etika mjekësore zakonisht reklamon kujdes për çdo pacient, sipas të dhënave aktuale shkencore dhe imponon një “detyrim për mjete” për mjekun përball çdo të sëmuri që gjendet seriozisht në pikëpyetje (para problemesh shëndetësore). Pra do duhet të përpunohen pa dyshim rregulla të reja etike në përputhje me bashkësinë shoqërore; për të fiksuar rregulla e kritere për çdo rast, që të përdoren të njëjtat principe të etikës mjekësore dhe nuk është “thjeshtë dialog” midis të sëmurëve dhe mjekëve.

Pra problemet e etikës e të Deontologjis janë të lidhura dhe me historinë e mjekësisë. Në Indinë e lashtë në veprën “Caranka sanihita”, shkruhet: - “Mund të ndrydhesh dhe të kesh turp nga babai, nëna, nga miqtë dhe nga mësuesi; por jo nga mjeku... se ai për të sëmurin është nëna dhe babai, mik dhe vëlla”... Në papirus të vitit 2700 para Jezus Krisht (J. C) jepen këto tipare morale për njeriun e mjekësisë: - “Tipare të rralla, të jetë i mirë, i zgjuar, i durueshëm, të mos ketë frikë nga gjaku dhe as nga kufomat”.

Në Greqinë antike dhe në Romë ka pasur shumë punime për etikën mjekësore dhe “Deontologjinë”, por betimi i Hyppocrat-it 500 vjet para Krishtit (J. C) vlerësohet si kodi i vjetër i Deontologjis, që nuk ka humbur vlerën as sot me këtë përmbajtje të shkurtër: “Beto hem se të sëmurëve nuk do tu shkaktoj asnjë dëm apo padrejtësi... Nuk do tu jap lëndë vdekje-prurësve dhe nuk do t’u tregoj rrugën për një veprim të tillë... nuk do të kryej aborte (dështime). Do të ushtroj profesionin me pastërti... Në çdo shtëpi do ti shërbej të sëmurit pa bërë dem... Do të re-

spektoj fshehtësinë mjekësore (sekretin profesional), për çdo gjë që shoh e dëgjoj, nuk do ta përhap, duke u mbajtur të fshehtë”...

Tiparet kryesore të etikës mjekësore në shoqëritë demokratike mbështeten në parimet themelore morale të vendeve të përparuara si: puna me ndërgjegje të lartë dhe përkushtim. Marrëdhënie sa më njerëzore midis të sëmurëve dhe personelit të shëndetësisë, thjeshtësia dhe modestia në jetën shoqërore dhe vetjake; solidariteti, delikatesa, qëndrimi i vëmendshëm në marrëdhëniet me të sëmurët dhe familjarët e tyre. Sot etika dhe deontologjia mjekësore njihet dhe organizohet si në gjithë vendet e tjera të botës dhe tek ne “Urdhri e MJEKUT” që u krijua në vitin 1993, që filloi të vihete në jetë me anë të betimit të Hyppocrat-it (i cili bëhej formalisht dhe me pare) si më poshtë:

“Në prani të profesorëve të mijë të kësaj shkolle, të kolegeve të mijë dhe para shenjës së Hypokrat-it; unë premtoj të bëhem dhe të jem besnik i ligjeve dhe i ndershmërisë në ushtrimin e profesionit të mjekut... Do jap, ndihmë falas për të varfrit dhe nuk do të kërkoj kurrë pagesë mbi atë që vlen puna ime. Duke hyrë në intimitetin e shtëpisë, sytë e mijë nuk do shohin atë që ndodh, gjuha ime do të ruaj sekretin që më besohet dhe sjellja ime nuk do të sjell dhe nuk do të favorizoj krimin. Duke respektuar dhe duke shpreh mirënjohjen ndaj profesorëve të mijë; unë do tu mësoj fëmijëve të tyre atë që kam mësuar prej prindërve të tyre. Të më nderojnë njerëzit në se jam besnik i premtimeve të mia”.

Profesioni i mjekut është sa i nderuar; po aq dhe i vështirë, ai duhet të karakterizohet nga disa virtyte si: humanizmi, mirësia, ndjenja e ngrohët dhe vetëmohues. Puna e mjekut veç të tjerash është një profesion që shtron kërkesa shumë të larta si ndaj mendjes dhe ndaj zemrës së tij. Këto shtrohen në betimin e GJENEVE-s të vitit 1983: “-Marr angazhim solemn se do të ve jetën time në shërbim të njerizimit... Do të ushtroj artin tim mjekësor me ndërgjegje e dinjitet. Do të konsideroj shëndetin e pacientit tim si preokupim kryesor. Do të respektoj sekretin e atij që ma beson, madje dhe pas vdekjes së pacientit. Do të ruaj nderin dhe traditat fisnike të profesionit mjekësor. Kolegët e mijë do të jenë vëllezërit e mijë. Nuk do të lejoj, që konsiderata fetare, kombëtare, racore, partiake ose klasore të ndikojnë në kryerjen e detyrës ndaj pacientit. Do të ruaj respektin absolut për jetën njerëzore edhe sikur të jem i kërcënuar nuk do të përdor njohurit e mia mjekësore kundër ligjeve të njerizimit”, sipas Kodit të Gjenevës, Betimi.

Po ashtu do të kemi parasysh deklaratën e Lisbonës për të drejtën e të sëmurëve – për të zgjedhur në mënyrë të lirë mjekun, për të refuzuar një mjek të caktuar, për të ruajtur sekretin e sëmundjes së vet; për të vdekur me dinjitet, për të pranuar ose refuzuar një ndihmë shpirtërore morale ose fetare. Në kodin e Deontologjis Neni 11, thekson: “Mbajtja e Sekretit profesional në interes të të sëmurit është e detyrueshme për gjithë njerëzit e shëndetësisë”, po ashtu në Nenin 294 të kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, mos mbajtja e këtij sekretit ose e kësaj të fshehte dënohet me gjobë dhe burgim deri në 5 vjet.

Në kongresin e fundit të Shoqatës ndërkombëtare “Mjekësia dhe ligji” shkruhet: “Një mjek që nxjerr në shesh një sekret profesional vullnetarisht është fajtor dhe shkel betimin e Hyppocatt-it si mjek; por po të japi të dhëna me interes për shoqërinë, mjedisin sipas kërkesave ligjore nuk ngarkohet me faj”. Për sa i takon të fshehtës ndaj vetë pacientit, Konventa Ndërkombëtare e Gjenevës e vitit 1987, duke prekur të drejtat dhe detyrat e ndërsjellta mjek – pacient; - kodi Deontologjik i njejtë drejtën që çdo pacient pas vizitës mjekësore të informohet për sëmundjen e tij, për prognozën (të ardhmen, perspektiven) e saj me trajtimin që merr.

Për këtë, në botë ka disa qëndrime. Qëndrimi i parë, Vënia në dijeni të plotë pa asnjë rezervë të pacientit dhe të familjarëve, kjo për sëmundjet dhe traumat jo të renda; ndërsa për sëmundje të renda me perspektive të rezervuar, patienti nuk do të marr vesh të vërtetën dhe duhet të mbahet me shpresë deri në fund, sido që është gënjeshtër, sipas Botkin kjo është “Gënjeshtër e mirë”, nga që është një akt jo imoral, por në interes të pacientit, që shpreh dimension njerëzor, gjeneron shpresë, ku “shpresa është doktori më i mirë në botë”. Sipas shprehjes Latine “Dum, spiro, spero” (Sa të kem frymë kam shpresë).

Qëndrimi i dytë, që i kundërvihet qëndrimit të parë (më sipërm), që i përmbahen Anglosanksonët (Anglo-amerikanët) për të sëmurët rëndë dhe të pa shpresë, pra që dhe kjo kategori duhet të njohë gjendjen e vet reale shëndetësore pa asnjë të fshehtë e gënjeshtër, sepse nuk është normale të gënjeshtër dhe herët a vonë i sëmuri do ta marr vesh, të vërtetën.

Qëndrimi i tretë, është një qëndrim i ndërmjetëm ku kodi deontologjik shprehet...”Mjekut i lejohet kur e sheh të arsyeshme të mos i tregojë të vërtetën për diagnozën dhe prognozën e një sëmundje me ecuri të keqe dhe vijon në nenin 40...”Prognoza fatale e një sëmundje në rast se thuhet, duhet

të formulohet me shumë kujdes e takt. Për këtë, sidoqoftë duhet dijë dhe familja ose persona të tjerë, kur atyre u besohet nga familja...”

Mjeku dhe konsulta mjekësore vendosin, duke u mbështet në gjendjen psikologjike të çdo patienti të veçantë; mund ti thuhet me shumë takt e kujdes diçka për sëmundjen për ta përgatitur atë gradualisht për gjendjen tij të rëndë, duke iu paraqitur i gatshëm për bashkëpunim në çdo kohë, për të bërë gjithçka munden për të mbijetuar, po kështu dhe për familjarët, sepse e kanë shumë të vështirë të përshtaten me ecurinë fatale të të afërmit të vet të shtrenjtë, shpesh ato reagojnë me ashpërsi duke u konfliktuar me mjekët; duke i akuzuar për mjekim të pa kujdesshëm deri në gjykata. Për këtë është detyrë e personelit mjek-infermier të jenë gjithnjë të durueshëm, duke u përprjekur të bëjnë më të mirën; çdo gjë sipas personit e nivelit të tij.

Në literaturën botërore publikohet rasti i një gruaje para një profesori të madh – pas operacionit – në të dhënat anatomo-pathologjike të tumorit të gjirit, kur profesori po i jepte përgjigjen – ajo e pyet... po tash pas kësaj dhe sa më ka mbetur të jetoj? Profesori i thyer në moshë pasi u mendua i tha: zonjë sa të jem gjallë unë ti nuk do vdesësh. Ajo ju hodh në krah profesorit dhe e përqafoi, të cilit iu kujtua shprehja latine “Dum, spiro, spero” (Sa të kem frymë, shpresoj)

Pra siç shihet etika mjekësore është e lidhur direkt me bio-etikën që përbën tërësinë e rregullave që i cituam më sipër, të cilat aplikohen në të gjitha fushat shkencore të jetës? Detyrat morale dhe të drejtat në ushtrimin e profesionit të mjekut si, në betimin e Hyppocrat-it, që u përmend e të tjera. Në vitin 1976 Asambleja parlamentare ose Komiteti i Ministrave të jashtëm të vendeve pjesëtarë llogariten aspektin etik të shkencës mjekësore dhe aspekte të veçanta të individit.

Në vitet 80-të u bënë rekomandimet për të drejtat e të sëmurëve, në fillim të viteve 90-të u fut nocioni i depistimit gjenetik dhe lejimi i kërkimeve mjekësore në embrione.

Në 1992 Komiteti Evropian e bio-etikës u pagëzua si Komiteti Drejtues për bio-etikën i Këshillit Evropian (C.D.B.I) i përbërë nga mjek, filozof, jurist, shkencëtar dhe anëtar të asamblesë Parlamentare të: “mbroj qenien humane në identitetin dhe dinjitetin e vet”.

**Përgatiti,
Dr. Med. NDUE NIKAJ**

*** POEZI *** ** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI

**FRIKA NDEZ DETIN**

Më thellë se në vetvete e burgosën veten
Në mendon seç ka mes të sotmes e së nesërmes
Me qerpik kafshon lotin në cep të syrit

Fare shkoqitur kjo mospërfille njerëzore
Këtej e përtej me mizori po regjen koha e stinët
E rëndë kjo fantazi e arratisjes nga vetja

Sikur të qe atje qoftë edhe një skaj
Në lashtësi të kohës të mbështilleshe
Të ardhmen tonë s'do e braktisnim

I padukshmi covid-19 edhe krojet i thau
Lisin prej lisave të malit e ndau
U zbukurua dimri pranverorë me stoli të acarta

Mbyllur e la njerëzinë fjala e trishtë
Ngrica mpiks tej përtej kohërave
Mbi hirin e përjetshëm të akullnajave pranverore

Moçali i hapur s'ka nevojë për dritare mbi plagë
Sipas një kodi s'dihej prej kujt
Fjala ngel jetime frika e kall detin
Seç shteg tek fundi fundëm të nxjerr një zot e di

Këto klithma më trembin e nata që hesht
Nuk e di në ndjen të ftohtë nga ngrica jashtë
Përtej mureve hermetike të erës

Apokalipsi covid ne operacion si ushtari mire Zhvejg
Karvanë krushqish që askund s'ju zë pritë
Me armen e shkatërrimit mbolli fillimin e fundit

Eh kjo njerëzia përgjumur qenë

IMAZH BUZË MBREMJE TETORI

Në këtë buzë mbrëmje fillim tetori
Freski e ëmbël ku shfaqet magjia
E dua të dhuroj këtë tufë vargësh

Dielli në perëndim përkëdhel vargmalet
Ama s'ua shuan dot flakën fantastike
Kështu pra
Kujdeset për grimimin e egoizmit njerëzorë

Qielli i kaltër e i bukur ky altarë i madh
Edhe ëndërrat shuajnë etjen në këtë hapësirë
Ndaj pjekurinë bashkoje ti me pafajësinë

Panoramë e kësaj mbrëmjeje
E tëra hareplote për tu pikturuar
E kaltra tërë çiltërsi
I gjithë horizonti bukuri vjeshte

Ky qiell i bukur një tetori
U zbukurua se dëgjoji zërin tënd melodioz
Sepse këngën tënde dhe qielli e dëgjoji

Dhe shpirti im
Le ti ngajë asaj kështjellës madhështore
Qoftë zjarr apo ngricë qoftë

Ndjenjë e ngazëllim përzier
Eh kjo puhizë e lehtë e kësaj mbrëmjeje

EH KJO VJESHTE NË IKJE

Më djeg kjo vjeshtë edhe kur i flet mallit
Në prag dimri në terrin e hutuar
Hirin do e ndez e dheun në flakë do e kallë

Bloza e than barin e mbirë mbi gërmadha
Si dielli është mendimi shiu apo era
Këto i druhen mallit tim
Të tregojnë shtegun kah mbrëmja

Në gjendesh mes të verdhës e të gjelbrës
Tek caku ku vjeshta jonë merr frymë
Me shpirtat e erës mund të flas
Edhe sikur të tretem si vjeshta a të tretem ndër sy me një
grusht mall

Hapat që hedh duhet mirë ti mat
Këto klithma më trembin e nata që hesht
Pasi as qielli s'është i kaltër gjithnjë
Eh dhe kjo vjeshtë në ikje

IMAZH I ETJES

Ngrohtësi të falë kjo verë vjeshte
Të gjalla ëndërrat jetojnë aty
Telat e zemrës luajnë melodi shpirti

Çdo çast po na rrëmben vjeshta
Imazhet mahnitëse shfaqen kudo
Asnjë moment se ndan mendimi
Nipërit atmosferën ngrohin

Petkun e ditës lozonjare vesh vjeshta
Plot ledhetime vijnë puhiza
Në skrofullën e zemrës pushpurit gëzimi
Në këto ditë vjeshte plot ngjyra

Të pafundme janë këto melodi të jetës
Me ngjyra i qëndis si vetë vjeshta
Adhurueshëm përformon mbi
Pentagramin e ëndërrave plot shpresa

Nga fanari i shpirtit dritat vezullojnë
Si puhizë e lehtë përshkon imagjinatën
Kjo vjeshta bashkë udhëtare
Ta fal dritën e përtej qiejve

DO TË KËNDOJË VJESHTA

*(Kushtuar nipçes Gjovalin Shkoza me rastin
e përvjetorit të datëlindjes)*

Do të këndoje vjeshta
Ndaj ëndërroj nën këtë qiellin jeshil
E mbjellë si parajsë gjithë dashuri hyjnore
Për ty nipçe zemra më përcjell ngazëllim

Me zemrën e madhe e shpirtin qelbarë
Dëlirësia jote lumturi na dhuron
Këtë përvjetor ditëlindje Gjovani sot feston

Dritë janë mbjellë pishinat e shpirtit tënd
Jehonë lëshon kënga prej vargut tim
E mbushur plot flluska energjie

Virtyt i bëhesh kësaj bote
Vjeshta e vargjeve do këndoje
Kënga përletet në pentagramin e jetës
Mall e dashuri i bëhesh asaj

I lindur në tetor njësh u bërë me stinën
Oaz i bëhesh qiellit si ajo streha e hapur
Qiellzohen emocionet si flatra melankolie

Ndjenjë dhe emocion të dhuron kjo ditë
Ti engjëll dëshire që dhuron lumturitë
Unë miq e farefis ti urojmë dhe 100.

JU MIQËSIA IME

Për ju miqësia ime
Në këtë ditë të bukur vjeshte
Fjalët do i mbledh e ti hedh në fletë

Ëmbëlsia le të mblillet në fjalorin e ditëve
Si klithmë le të dëgjohet deri prapa diellit
Fryma e besimit në emër të engjëjve të bekojë

Le ti mbarë shtojmë ditët e bardha
Gjaku i miqësisë të depërtojë ndër damarë
Sepse dhe pika e ujit i thërret burimit

Honit të ndarjes ti mbyllim dritare e derë
Në shpirtat tanë mbifitë vjeshta me ngjyra
Bujarja e fisme deri në kupën e qiellit

Edhe kjo dekadë po e mbyll historinë
Nëse sekretit i ecjes përpara qëndron tek nisja
Arritja le të jemi ne në dekadën e re

Jetës le ti japim më shumë jetë
Nëpër fushat e bleruara të mendimeve
Mbi dallgët e blerta të ujitur nga uji jeshil
Për miqësinë e vërtetë

VJESHTË NË MANHATTAN

Ashtu si sot
Vjeshtë në Manhattan qe aso kohe
U ndje hingëllima e kalit kuq
Edhe sot seç i ndjehet oshtima

Plot ligjërata qenë mbushur gojë
Vijnë shtegtarët e vizitojnë gjethet mbi emër
Eh dhe aty fati desh shqiptarë pati

Lëkundet përmendorja bien shpend e gjethe
Gjithçka munda të ndodhë aty në brigje
Atë ditë të 11 shtatori në vjeshtë
Çakejtë ndër nahije qenë

Botën mos shiko thonë asnjëherë për gjykim
Vizitat poshtë e lart nëpër dhimbje shpirti
Vjedhja e kohës
Dhuruar ndër imazhe portretesh

Eh ajo e madhja energji kozmike
Lindur e harlisur nëpër dhimbje të kohës
Ai burim i etjes njerëzore me artin e mashtrimit këmbëkryq
dhe sot

Kënga e fjala lëshon lotët e vargut
Pas atyre shtëllungave tymi
Edhe nata pati zënë vend
Me hipoteza lëshoi nga pak frymëmarrjet
Mespërmes pyetjeve të pazgjdhura ende

KËNGËN TA THUR O YLLËSI

*(Me rastin e dy vjetorit lindjes
Ryan Çela)*

Këngën më të bukur do e thur o yllësi
Do ua jap bilbilave ta këndojnë për ty
Ryan bashkë me vjeshtën
Gëzofshin në përjetësi

Fjalët më të ëmbla dua ti vargëzoj
Madhështia le të shtohet mbi këtë tokë
Për Edlir dhe Donika je princi parë në botë

Sa do doja të kem pranë e të ledhatoj
E t'kënaqesha pafund në këtë dy vjetor
Linde si princ e të udhëheqësh si perandor

Ti o rreze drite horizontet i shndrit
O engjëll i dëshirës ti zemrat na i rritë
Gjendesh tej atlantikut por të kam në shpirt

Ti engjëll i ëndërrave i tëri qelbarë
Në këtë ditë vjeshte pafund të festosh
Në pedestalin e kohës Ryan mbretërofsh

Të uroj ylli vogël një qiell lumturi
Brenda honeve të shpirtit je e madhja mrekulli
Urime datëlindja i bukuri Ryan
Gëzuar e dita t'u bëftë 1.000

Edhe vjeshta Ryan
Ngazëllen për ty

E NESERMJA LE TË JENI JU

Ky diell vjeshte shndrit gjithësinë
Janë ndezur orët e ditës sotme
Atje krye udhës ziente gumëzhimi

Një shi fjalësh iu derdh në trup me mirësi
Fytyrat e ëmbëlsuara e shpirtrat e ndritur
Se ardhmëria pranverore vetëm ditët numëron
E orët mbrapsht

Mes freskisë krijohet etje
Në dete krihet dielli i përskuqur
Zogjtë e fjalës frymëzohen rrezeve të vargut

Mendimit të mirë udhët t'ia ndriçojmë
Se engjëjt e ndreqin botën nga e para
Si princër a princesha në fron ngjan

Kjo historia jonë le ti zgjerojë kufijtë e kohës
Rolin e perëndive mbi dhe kush e bën mirë
Epo, ju gjaku i ri LRI
Që sot dritë jepni së ardhmes

Eh, e nesërmja le të jeni ju

U ÇMEND KJO VJESHTË

U çmend e u lajthit nga shpifjet edhe kjo vjeshtë
Sikur të qe mbyllur në luksin e tepruar të mos kokëçarjes
Brenda unazës së izoluar të mashtrimit
ku egoizmi e mban mbi kësulë

Kokrrat e mendimit një e nga një po
ua vërtitë kjo vjeshtë me befasi dhelpre
Ngucamat e përmotshme në kala ngrihen përmes
shkretëtirash e të pamundurës ia cek shpatullën
Pikë për pikë të drejtën shkërmoq
Koha ka ardhur të kristalizohen mendimet
E zemra e gurit të thotë fjalën e fundit

Vjeshta copëtohet me ngjyrat e thyera të dritës
Pëlçet dhimbja e në fund trishtimi e tremb
Edhe vozin e verës gardhina e vet e thyen
Thyhet mes lojërave kupola e mendimit Kësisoj
Lart e poshtë endesh nëpër dhimbje
Duke parë dhimbjen e kohës sate

E JONA ËSHTË ASGJËJA

Nata mbulon gjithësinë me vellon e saj
Udhëtimin bën drejt një dite të re
Eklipsi i vjeshtës në ditët e para

Kjo do të thotë të kapërcesh stinët
Shkallminave të shpresës
Të depërtosh si i çmendur
Të kërkosh një zë a këngë bilbili

E dridhshme e padukshme ndjehet vjeshta
Gjurmë lenë mbi ajrin e ngrohtë të covid
Ku ngjan me valset e Shtrausit
Dhe rrënojat e kujtesës brezave

Eh kjo vjeshtë e denjë për karnavale
Kurrë të nginjur në gropëzat shpirtit
Të fortit i deh ajo magji e tmerrit

Edhe Tolstoit po ia djegin luftën dhe paqen
Lumenj të rrëmbyer vërshojnë në mund
të shuajnë mendjet e djallit
Në mund t'ua freskojnë ferrin për gjëmën që botës i kanosën
Koha e hapësira shtrirë tej e tej Si një qiell i mbjellë me yje
Lavdi i thurin këtij populli që fjalët e zotit përjeton

E jona është asgjëja
As hiri as flaka as ringjallja e një plage

Dëgjona o zot mos na lër fillikat
Sepse kjo stinë sapo vazhdoj udhëtimin

Besimi ynë le të jetojë gjer në vdekje

ZË JU LËSHON KORABI

Udhëtimi nëpër trojet shqiptare,
imazh mrekullish
Shkëndijë e ndjenjës kombëtare,
etje e lirisë

Siç ka dielli dritë e ngrohtësi,
dashuri e besë rron virtyti
Atje ku takon vlerën njerëzore,
atje ndriçon dhe shpirti

Syri mbushur dritë,
E ndriçon gjithë errësirën
Është kënaqësi shpirtërore,
Të përshkruash Dibrën

Epoka flet
Le ti zgjerojmë kufijtë e kohës
Trimërinë e zgjuarsinë
Ia dëshmuar botës

Për ty o malësi
Buzë brigjeve të Drinit
Për nder e vatan prekët
Dhe anën tjetër të diellit

Luftuat ndaj hordhive
O ju bijtë e shqipës
Nderin e lavdinë
Ia dedikuar Dibrën

Shekujt flasin për ty
Që para erës së re
Dobra e asaj kohe lavdishëm
Dibër erdhi deri tek ne

Në maja të thepisura qe kryqëzuar fati
Të jetonin të ndarë dibranët e një gjaku

Dibranët fisnikë deshën komb e atdhe
Trojet e vatanin mbrojtën kulturë e fe

Asgjë nuk ju mposhti o djem vigana
Trimat si luanë me vashat si zana

Zë ju lëshon Korabi vargmaleve të Lurës
Fjalë i çoni Mirditës Kukësit e Pukës

Në një sofër jemi së bashku o vëllezër
Madhështi e këtyre trojeve i mahniti brezat

Zjarri arbërorë që na mbajti zgjuar
Si qiri do jemi që s'mund të ketë të shuar

IMAZH BUZË MBREMJE TETORI

Në këtë buzë mbrëmje fillim tetori
Freski e ëmbël ku shfaqet magjia
E dua të dhuroj këtë tufë vargësh

Dielli në perëndim përkëdhel vargmalet
Ama s'ua shuan dot flakën fantastike Kështu pra
Kujdeset për grimimin e egoizmit njerëzorë

Qielli i kaltër e i bukur ky altarë i madh
Edhe ëndërrat shuajnë etjen në këtë hapësirë
Ndaj pjekurinë bashkoje ti me pafajësinë
Panoramë e kësaj mbrëmjeje
E tëra hareplotë për tu pikturuar
E kaltra tërë çiltërsi I gjithë horizonti bukuri vjeshte

Ky qiell i bukur një tetori
U zbukurua se dëgjoi zërin tënd melodioz

Sepse këngën tënde dhe qielli e dëgjoi

Dhe shpirti im Le ti ngajë asaj
këshqjellës madhështore
Qoftë zjarr apo ngricë qoftë
Ndjenjë e ngazëllim përzier
Eh kjo puhizë e lehtë e kësaj mbrëmjeje

EDHE STINËT LEMERISEN

Edhe stinët u mplakën
U mplakën dhe motmotet
U dergj kjo verë u tha e tëra
Pasi të infektuar e dorëzoi vjeshta

Dyndshim e jetuam këtë acar
Të maskuar nga mashtrimi endacak
Ethshëm mund të klithë sot e 1.000 vjet

U turrën si fantazmat e natës
Me mëri e vdekje
Nga pusi i pashtershëm
I mashtrimeve e gabimeve

Edhe stinët lemerisen nga gjithë kjo smirë
Se elitat luajnë teatër me karikatura
Ushqejnë errësirën e ajo fryhet

Qeshin e shpoti bëjnë
Dete i pa anë na ngushëllo
Na ngushëllo vuajtje tona

ME VJESHTEN MIKE

Me të hyrë vjeshta i rrëmbeva dhe fjalët
Shpirtin e mbusha me ngjyrat e saj
Për mua u bë ëndërr e gjallë

Me vjeshtën mike çdo ditë udhëtoj
Seç më magjeps natyrë e saj
Në gjunjë përkulem magjinë ja ledhatoj

Me ty do doja ta ndreqja botën nga e para
Me ëndërrat ta ndez semaforin e shpresës
Kjo ndjesi më vë në gara

Në pritje të hapet drita e blertë
Pa humorin rebel por shpresën e gjallë
Apo ajo streha e hapur ndaj qiejve
Pa prekur më parë
Ai diell ngroh gjithësinë

PAS BRYMËS VJESHTORE

A mendon se në verën që sapo lamë pas
Dimri i acartë qe ulur këmbëkryq

Një për një i numëronin gjahtarët e covid-19
Pretë e tyre fatkeqe tek i murosnin nën rrënojat e tempujve të
faraonëve të rinj

Ky gjumë i shtirur a gjurmë të fshira
Si në ëndërr teatër kukullash prej leckë
Nëse ende mëton ta gesh një kuptim
Eh zhytur në habi se si oqeanit i
shpalosen dallgët

Meteorologët parashikojnë se
Akoma më të acarta do jenë ditët që do vijjnë
Me ndërrimin e stinëve

Pas brymës vjeshtore
Borëra e shira të qelqtë do të duken
Ndër mjegullnaja mbi kodra e lëndina

Eh në ulërijnë atje lart mbi kodra
Duhet ta dimë se radhën e kanë
Ja pra, ujqërit janë ata.

REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
AGRON HASANAJ

